



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.9013/2023

Në bazë të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale numër Nr. 03/L-40 neni 43, nenit 31 të Statutit të Komunës së Hani të Elezit, bëjë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni që të merrni pjesë në mbledhjen e dhjetë -X- të rregullt për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet me datë 31.10.2023 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2023.
3. Planit i biznesit të N.P.L Pastrimi sh.a. për vitin 2024.
4. Draft Planit i Veprimit për Parandalimin e Dhunës në Familje 2024-2026.
5. Draft Planit i Punës së Ekipës për Mbrojtjen e të Drejtave të fëmijëve 2024-2026.
6. Propozim vendim për lirimin nga taksa administrative për legalizimin e ndërtimeve pa leje për kategoritë e dalura nga lufta.
7. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit.
8. Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2023 i N.P.L Pastrimi sh.a.
9. Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik 2023/2027.
10. Të ndryshme.

Bashkë me ftesën ju dërgojmë:-

- Procesverbalin nga mbledhja e kaluar.
- Materialin e raportit financiar për periudhën Janar – Shtator 2023.
- Materialin e Planit të biznesit të N.P.L Pastrimi sh.a. për vitin 2024.
- Materialin e Draft Planit të Veprimit për Parandalimin e Dhunës në Familje 2024-2026.
- Materialin e Draft Planit të Punës së Ekipës për Mbrojtjen e të Drejtave të fëmijëve 2024-2026.
- Materialin e propozim vendimit për lirimin nga taksa administrative për legalizimin e ndërtimeve pa leje për kategoritë e dalura nga lufta.
- Materialin e raportit periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit.
- Materialin e raportit financiar për periudhën Janar – Shtator 2023 i N.P.L Pastrimi sh.a.
- Materialin e hartimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik 2023/2027.

Hani i Elezit
Data:-20.10.2023

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.9014/2023
Data:20.10.2023

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e nëntë -IX- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 28.09.2023 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Rezart Mehmedi** (Përfaqësues i OSB-së), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Informim). Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës. Para se të fillojmë me procedimin e pikave të rendit të punës kërkoj që të mbajmë një minutë heshtje për nder të rënies së Policisë të Kosovës në Mitrovicë. Lavdi.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Buxheti i komunës për vitin 2024 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2025-2026.
3. Rregullore për taksa komunale për vitin 2024.
4. Plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2024.
5. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2023/2024.
6. Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik 2023/2027.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Buxheti i komunës për vitin 2024 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2025-2026.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- buxheti i komunës së Hanit të Elezit është një plan fiskal që përcakton të hyrat dhe shpenzimet e parashikuara për të udhëhequr shërbimet dhe politikën që zbatohen gjatë vitit fiskal 2024. Ai përcakton bazat për ato që do të jenë qëllimet dhe arritjet e Komunitetit tonë. Për të zbatuar prioritetet e mësipërme buxheti për vitin fiskal 2024 ka përfshirë gamën e plotë të operacioneve dhe programeve komunale të cilat janë shënuar më poshtmet: Zyra e Kryetarit, Administrata dhe Personeli, Zyra e Kuvendit Komunal, Buxheti dhe Financat, Shërbimet Publike, Emergjencë dhe Mbrojtje Civile, Zyra për Komunitete dhe Kthim, Bujqësia Pylltari dhe Zhvillimi Rural, Zhvillimi Ekonomik dhe Turizmi, Planifikimi Urban dhe Inspeksioni, Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale, arsimi dhe Shkenca, Kultura dhe Sporti. Në buxhet janë të planifikuara edhe inkasimi i të hyrave vetanake. Buxheti për vitin 2024 është në shumë prej 3,349,278.00 €. Në kategorinë paga dhe shtesa janë planifikuar 2,075,272.00 €, në kategorinë mallra dhe shërbime janë planifikuar 524,500.00 €, në kategorinë shpenzime komunale janë planifikuar 93,500.00 €, në kategorinë subvencione dhe transfere janë planifikuar 113,000.00 €, në kategorinë e shpenzimeve kapitale janë planifikuar 543,006.00 €. Në material e keni të planifikuar planin e ndarjeve buxhetore nëpër kategoritë buxhetore dhe financimin e investimeve kapitale komunale.

Zaim Bela thekson:-sa i përket buxhetit do të votoj kundër sepse nuk kam parë ndonjë projekt për shkak se ne e dimë që të hyrat kapitale janë shumë të vogla dhe nuk është përmbushur as 90 % e kërkesave të qytetarëve. Sikur të kish qenë që të hyrat kapitale me u destinuar për ujin e pishëm diku 50 % do ta kisha votuar. Parqet që janë ndërtuar janë të mira por nevoja e qytetarëve për ujë të pishëm është më e madhe sepse ndonjë kërkesë tjetër për rrugë apo për kanalizim.

Resul Suma thekson:- si grup parlamentarë kemi vërejtjet tona sa i përket planifikimeve buxhetore por i kemi edhe disa propozime të cilat kemi me i propozuar për votim. Debat publikë për çështje të buxhetit për qytetarët e Komunës së Hanit të Elezit nuk ka pasur. Është e vërtetë ajo që potencoj z.Zaim Bela që shumica e kërkesave të qytetarëve prej dëgjimeve publike nuk janë përfill. Nëse nuk votohen propozimet të cilat do t'i propozon grupi parlamentarë i PDK-së ky buxhet nuk kalon. Jemi të gatshëm me i bartur edhe pasojat si anëtarë të kuvendit nëse nuk kalon buxheti. Unë do t'i paraqes propozimet një nga një dhe kërkohet që të hedhen në votim. Propozoj që në planifikimet buxhetore për vitin 2024 të hynë Asfaltimi i rrugës Nehat Curri. Propozoj që në planifikimet buxhetore për vitin 2024 të hynë Ndërtimi i rrugës nën breg në fshatin Seçishtë. Ndërtimi i rezervarit të ujit në fshatin Seçishtë në vendin e quajtur Sarasell propozoj që të hynë vetëm si kod buxhetor sepse kemi premtime prej kompanisë "Sharrcem" dhe ka filluar me bërë fizibilitetin. Zgjerimi i rrugës "Adem Jashari" 11 Qershori është projekt që ka filluar prej Ministrisë por ka nevojë edhe për disa fonde shtesë propozoj që të hynë si projekt. Shtrimi me kupëza betoni i rrugës të Varrezat e lagjes Meliq propozoj që të specifikohet. Asfaltimi i rrugës Hani i Elezit –Dimcë është rrugë e re që i nevojitet fshatit për shkak të rrezikshmërisë dhe propozojmë që ky projekt të hynë në vitin 2025. Ndërtimi i rrugës në vendin e quajtur Vorba në fshatin Seçishtë mundet me hyjë te kodi ekonomik rihapja, zgjerimi i rrugëve, asfaltimi i rrugëve në fshatrat Paldenicë, Seçishtë, Dimcë, Pustenik, Gorancë, Rezhancë dhe Krivenikë por kjo duhet të specifikohet.

Refet Kalisi thekson:- duhet t'i ipet prioritet rrugës në vendin e quajtur Vorba.

Kryesuesi thekson:-propozimet që do të parashirohen nga anëtarët e kuvendit do t'i hedh në votim një nga një për hyrë të procedurës. Propozimin që në planifikimet buxhetore për vitin 2024 të hynë Asfaltimi i rrugës Nehat Curri e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Propozimin që në planifikimet buxhetore për vitin 2024 të hynë Ndërtimi i rrugës nën breg në fshatin Seçishtë, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Propozimin për Ndërtimin e rezervarit të ujit në fshatin Seçishtë në vendin e quajtur Sarasell që të hyjë vetëm si kod buxhetor e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Propozimin për Zgjerimin i Rrugës "Adem Jashari" 11 Qershori e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 14 për 1 kundër 1 abstenim. Propozimin që në planifikimet buxhetore për vitin 2025 të hynë Asfaltimi i rrugës Hani i Elezit –Dimcë, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

Sherif Berisha thekson:-ndërtimi i krojeve ku është paraparë me u ndërtuar dhe po ashtu kërkoj që nga ky kod të hiqen fshatrat Dimcë, Paldenicë sepse rregullimi i krojeve për këta dy fshatra është bërë. Ndrërimi në të gjitha fshatrat e Hanit të Elezit të gjithë e dimë që ka përfunduar dhe është mirë të bëhet mirëmbajtja e ndrërimin publik nëpër fshatra. Cilat rrugë do të riparohen sepse gjitha e dimë që gjitha fshatrat janë të asfaltuara dhe është mirë që të specifikohen se në cilat fshatra do të riparohen këto rrugë . Ku është lokacioni për mbetje të ngurta dhe nga kush do të mirëmbahet dhe a mendoni që planifikimi prej pesëmbëdhjetë mijë euro a janë të mjaftueshme për përfundimin e këtij projekti. Për cilin ujë bëhet fjalë dhe pse është përfshirë lagjja e re, por pse nuk fokusoheni në zgjedhjen e problemit të ujit në qendër kur e çimë që nuk ka ujë dhe a mendoni që vlera e ndarë prej 23000 € është e duhur . Te projekti me numër njëmbëdhjetë për çka bëhet fjalë. Duke e ditur rëndësinë e rrugës Krivenik - Gorancë dhe duke ditur koston e kësaj rruge që është milionëshe dhe planifikimi nga ana e juaj është në shumë prej 5000 € . Nga gjitha fshatrat për të cilat kemi njohuri vetëm fshati Krivenik dhe Pusteni nuk e kanë të rregulluar çështjen e kanalizimit dhe pse kjo vlerë kaq e lartë për këtë projekt. Ndërtimi i mureve mbrojtëse për ku bëhet fjalë. Projekti për shpronësim nga është marr ky planifikim sepse për procedura të shpronësimit vlerësimi bëhet nga komisioni dhe a është vlerësuar me komision ky planifikim në vlerë prej 80 000 €. Të gjithë e dimë që Hani i Elezit është vend malorë dhe nuk na duhet hapësirë gjelbëruese apo parku në fshatin Paldenicë bash në këtë fazë. Ndërtimi i aneksit të Urës së fshatit Seçisht të gjithë e dimë që ka përfunduar. Në cilat vende planifikoni vendosjen e këndit të lojërave. Kërkoj sqarim sa i përket objektit të shkollës kur dihet që prona është private. Edhe pse është rrit buxheti në sektorin e shëndetësisë pushteti aktual sipas Lëvizjes Vetë Vendosi nuk po dinë ta planifikon këtë buxhet dhe ky sektor është bajagi senzitiv. Në drejtori të shëndetësi është mungesa e mjekëve të përgjithshëm, mungesa e dokumentacionit të nevojshëm shëndetësorë, mungesa e konsultave specialistike , internistë , peditër , kardiolog , mungesa e terapive esenciale , mungesa e vizitave shtëpiake, mungesa e mjekut në AMF-në në fshatin Gorancë , mungesa e aparateve të cilat asnjë nga këto nuk po i bënë përshtypje me i paraparë në buxhet . Kërkoj nga drejtorja për financa që të më informoi se sa procedura përmbartimi keni në proces në sektorin e arsimit , të shëndetësisë, të administratës për shujta, për kualifikimet dhe inflacionit. Në emër të Lëvizjes Vetë Vendosi do t'i prezantoj projektet dhe kërkoj nga asamblistët të përkrahen këto projekte. Vendosija e ekranit të rezultateve të ndotjes së ajrit në qendër të Hanit të Elezit . Subvencionimin e lindjes që aktualisht është 100 € të rritet në vlerë 200 € . Subvencionimin e organizatave të dalura nga lufta . Vendosija e pajisjes digjitale Ekioska për nxjerrjen e dokumenteve të gjendjes civile . Blerjen e disa shtëpizave nga druri që të vendosen për shitjen e produkteve vendore. Kërkoj që të hynë rruga Bajpasi në fshatin Gorancë për vitin 2024. Pishina në fshatin Gorancë ka filluar me u rregulluar nga një person privat dhe kërkoj që të hynë si projekt. Kërkoj që të ndahet buxhet për mirëmbajtjen e parkut. Kërkoj që objektin e komunës me pasur qasje për persona me aftësi të kufizuara. Si lëvizje Vetëvendosje kërkoj që këto projekte të hyjnë në planifikimet buxhetore dhe nëse nuk përfshihen këto projekte në planifikimet buxhetore nuk do ta votojmë buxhetin. Si lëvizje Vetëvendosje rekomandojmë që 70 % e projekteve të hiqen dhe mjetet financiare të dedikohen për ujë.

Nexhmedin Daci thekson:- ndërtimi i krojeve do të prolongohet për vitin 2025 për shkak të propozimeve të cilat i miratuar sa i përket emërtimit më herët e ka marr atë kodë dhe në fshatrat që janë rregulluar krojet nuk kemi qasje me ndërtuar. Sa i përket projektit të riparimit të rrugëve është projekt standard që gjatë vitit do të rregullohen rrugët që bëhen gropa. Depoja e mbetjeve të ngurta lokacioni është paraparë në vendin e quajtur Zheden . Ndërtimi i depos për mbetjet e ngurta e kemi obligim ligjorë me bërë dhe janë ndarë mjete aq sa kemi mundësi. Projekti i rrugës Gorancë-Krivenik është projekt mbi një milionë euro është dërguar në Ministri përkatëse dhe ndoshta ka mundësi me miratuar apo përmes donatorëve me mundur me rregulluar , do të thotë se është projekt që duhet të kryhet por me mundësit tona buxhetore nuk mundemi me kryer. Projekti i kanalizimeve emërtimi është standard sepse me vite është ky emërtim dhe shuma prej 50 000 € është për rregullimin e kanalizimit për fshatin Pusteni . Projekti i mureve mbrojtëse është i paraparë të shkolla e mesme. Sa i përket shpronësimeve e kemi dorëzuar elaboratin e shpenzimeve për parcelën e fabrika e ujit, të fushës së futbollit për shkak se pronat janë të AKP-së dhe nëse Qeveria e miraton kërkesën tonë në bazë të Ligjit 80 % të vlerës e kryen Qeveria , po ashtu e kemi edhe hapësirën e cila është në emër të z.Refik Luri është e paraparë për vitin e ardhshëm , ndërsa sa i përket shumës i kemi ndarë mjetet dhe në momentin që merret vendim për shpronësim të parcelave komisioni nga Ministria e Financave e përcakton çmimin. Projekti i parku në fshatin Paldenicë nuk do të realizohet në vitin e ardhshëm por prolongohet për vitin 2025. Aneksi i

Urës së Seçishtës është kryer por është kërkesë e banorëve që edhe në anën tjetër me u bërë aneks por edhe ky projekt do të prolongohet për vitin 2025 por në vitin e ardhshëm do të bëhen testimet se a ka mundësi edhe kësaj ane me u bërë shtesë. Te ndërtimi i këndeve të lojërave punimet janë duke u zhvilluar në Gorancë dhe ky projekt për vitin e ardhshëm do të prolongohet për vitin 2025. Për vendosjen e ekranit të ndotjes jemi takuar me drejtorin e shkollës fillore së bashku me përfaqësuesit e Ministrisë dhe kanë pranuar që stacionin me transferuar por ende nuk na u kanë paraqitur përfaqësuesit e Ministrisë. Vendosjen e Ekioskës e kemi pasur si projekt por mirëmbajtja është e shtrenjtë dhe nuk kemi probleme për shërbime. Çështja e vendosjes së shtëpizave është ide e mirë por nuk është projekt kapital por prej mallrave dhe shërbimeve mundet mu bërë. Sa i përket mirëmbajtjes së parkut kemi biseduar me kompaninë Pastrimi për këtë çështje dhe nuk është projekt kapital.

Mehmet Ballazhi thekson:- te ndërtimi i shkollës është iniciativë dhe është krijuar fondi që edhe ju e keni mbështetur këtë fond dhe keni dhënë mjete financiare por ne po planifikojmë sepse në fushën arsimit kemi objektiva të qarta që me pasur cilësi të arsimit në mënyrë që me avancuar arsimin dhe pas kësaj vjen arsimi gjithë ditore për shkak se është cilësorë. Do të shikohen mundësitë buxhetore që në vitet në vijim me bërë digjitalizimin në të gjitha klasët. Ju e dini që kemi kërkesa të mëdha të çerdhes, kemi kërkesa të fushave sportive. Te ndërtimi i shkollës nuk ka asgjë individuale dhe e dimë që nuk mundemi me realizuar me këtë buxhet por edhe projektet të cilat i planifikuar nuk e dimë a do të realizohen me këtë buxhet por do të mundohemi përmes donacioneve dhe prej mbështetjes prej Qeverisë. Kjo shkollë është e domosdoshme dhe jemi në proces të blerjes së parcelës që pjesa e parë është kryer dhe në këtë vit e kemi pjesën e dytë. Takim kemi pasur me Ministren e Arsimit e kemi diskutuar dhe e kemi sqaruar por është e mendimit për me u ndërtuar por duhet të kemi parcelë për ndërtimin e shkollës. U potencua që 70 % e projekteve por unë them që njëqind për qind por merreni bëni llogarinë sepse nëse thuhet një rrugë Bajpas në fshatin Gorancë duhet ta dimë sa kushton, rruga Gorancë – Krivenik, pishinën që u potencuar duhet t'i analizojmë se sa na kushtojnë këto projekte dhe për mos me i përsëritur të gjitha a kemi llogari se sa mjete nevojiten për me i realizuar këto. Nga viti 2013 është një studimi i fizibilitetit që është paguar dhe për menaxhim por në javë e kaluar e kemi gjetur me një fjalë diku që s'është bërë asnjë herë. Fshati Gorancë është kryer sa i përket çështjes së ujit, fabrikën e ujit e kemi funksionalizuar e kemi shtijë në proces të punimeve dhe asnjë hap nuk e keni bërë rreth funksionalizimit të fabrikës por jemi të shqetësuar për këtë çështje. Jemi në proces të vendosjes së ujë matësve dhe keqpërdorimeve të ujit që janë bërë. Unë potencova veprimin më të sigurtë veproni në bazë të projekteve duke u bazuar në buxhetin të cilin e kemi sepse dëshirat e mia janë më të mëdha se të juajat. Potencuat ashensorin në komunë por është ndër projektet e para që e kemi hartuar ashensorin në komunë dhe nuk kemi mjete financiare. Te çështja e OJQ-ve kur bëhet shpallja për subvencionimin e OJQ-ve del e njëjta për të gjithë, nëse ka dikush ndonjë vërejtje për ndonjë shkelje që është bërë mundet mu paraqitë por thirrja është e njëjtë për OJQ-të sepse kriteret i ka miratuar kuvendi dhe në bazë të kriterëve ata që i kanë plotësuar kriteret i kemi ndarë.

Zaim Bela thekson:- pozita e paska rregulluar punën, numrat i keni por propozimet që i propozuan dhe mundën me i votuar. Përfaqësues nga fshati Paldenicë kemi dhe asnjë projekt nuk e pash në planifikimet buxhetore për pos parkut që ke dhe prolongua për vitin 2025. Nuk pajtohem me atë që thuhet rruga për në vendin e quajtur Vorba kana me rëndësi, nuk kana me rëndësi rruga që e lidh fshatin Paldenicë që kërkohet në vend kalim dhe problem me pronën nuk ka. A nuk është me rëndësi rruga me u ndërtuar në fshatin Vortomicë për shkak se një varrim po bëhet po ka vështirësi. Kërkesë ka pasur lagjja Thaç që kanalizimit e Paldeincës me u ndërtuar e mos me rënë në ato bunar që shfrytëzohen për ujë të pijes. Është mirë me u ndërtuar rrugët me prioritet ku jetojnë banorët.

Kryesuesi thekson:-nuk është mirë që të potencohet se i keni numrat sepse edhe unë kam qenë në opozitë dhe këtë fjalë nuk e kam potencuar. Propozimet e z.Sherif Berisha i hedh në votim; rezultati i votimit ishte 6 për, 8 kundër do të thotë që nuk kalojnë propozimet.

Refet Kalisi thekson:- kërkesë kam që të varrezat e qytetit nuk kemi bërë asgjë dhe duhet të ndajmë mjete për me i rregulluar.

Ajnure Thaçi thekson:-faqe trembëdhjetë te pika njëmbëdhjetë mjetet e lira për bashkë investime keni shënuar 65 000 € . Te pika katëmbëdhjetë rregullimi i kanalizimeve në Han të Elezit besoj që është një gabim teknik dhe duhet të rregullohen shifrat në total, rregullimi i prockave dhe kanalizimeve në fshatrat Paldenicë, Rezhancë, Seçishtë mendoj që është gabim shira të cilën e keni shënuar në total. Pika njëzet e një shtrimi me kupëza betoni edhe këtu në shifrën totale është shënuar gabim. Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve në fshatra shifrën totale është shënuar gabim. Është mirë që të analizohen këto shifra dhe të përmirësohen.

Nexhmedin Daci thekson:- i propozoj Kuvendit të Komunës që nga lista e projekteve ekzistuese kapitale të prolongohen për realizim këto projekte. Rregullimi i krojeve publike në Han të Elezit në fshatrat Dërmjak, Dimcë , Paldenicë, Pusteni dhe Rezhancë në shumë 10000, ndërtimi i parkut në fshatin Paldenicë në shumë prej 20 000 , ndërtimi dhe rregullimi i këndeve të lojërave në Han të Elezit dhe fshatrat Gorancë, Seçishtë Paldenicë në shumë prej 13500 , ndërtimi i aneksit për këmbësorë te Ura e Seçishtës në shumë prej 25000. Kërkoj që këto projekte kapitale të pronlogohen për vitin 2025 dhe shuma e mjeteve të shpërndahet në projektet që u miratuan.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse ruk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 11 për 4 kundër.

U MIRATU BUXHETI I KOMUNËS PËR VITIN 2024 DHE PARASHIKIMET BUXHETORE PËR VITIN 2025-2026

3. Rregullore për taksa komunale për vitin 2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Majlinda Kaloshi thekson:- pas procedurave administrative rregullorja i është nënshtruar debatit publik dhe nuk ka pasur ndonjë propozim përveç propozimeve të cilat i kemi përcjellë në seancën e kaluar.

Zaim Bela thekson:- nga rregullorja e më hershme a ka pasur ndryshme apo janë të njëjtat. Te kadastru certifikata e pronë deri në dhjetë faqe është katër euro dhe mbi dhjetë faqe njëzet euro, kërkoj sqarim. Te drejtoria e arsimit është shënuar taksa njëqind euro për regjistrimin e vitit shkollorë.

Nexhmedin Daci thekson:- sa i përket kadastrit këto tarifa nuk i përcaktojmë na por agjensioni i kadastral dhe na punojmë në bazë të çmimorës së tyre.

Hisni Luri thekson:- arsimi për të rritur nënkupton për ata të cilët nuk kanë mundur me marr certifikata dhe të cilët duhet me vijuar mësimin duhet më bërë pagesë për me kryer shkollën e mesëm.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse ruk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 13 për 1 abstenim.

U MIRATU RREGULLORJA PËR TAKSA KOMUNALE PËR VITIN 2024

4. Plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse ruk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2024

5. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2023/2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Hisni Luri thekson:- në informatë janë shënuar të gjitha të dhënat në detaje dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Zaim Bela thekson:- me një raport shënon se 157 nxënës janë në minus ndërsa e ke shënuar vetëm 82 nxënës.

Hisni Luri thekson:- do ta shikoj se ndoshta mund të jetë gabim teknik.

Refet Kalisi thekson:- teknologjia po shkon përpara por fëmijët shumë dobët dhe po më brengosë sepse unë flas për fëmijën tim dhe për këtë arsimtarët dhe profesorët nuk janë fajtorë por në klasë të ulët duhet me ju përkushtuar shumë sepse nëse e merr bazën prej fillimit shkon përpara.

Hisni Luri thekson:- sa i përket niveli ulët e kemi pas raportin dhe nota ka qenë katër që çdo të thotë nuk është e ulët por teknologjia është krijuar me i bashkuar personat por kur keqpërdoret mund t'i largon ata persona por ideja është mos me u kthyer mbrapa dhe për këtë arsye kemi planifikuar trajnime për mësime dhe për ciklin e ulët që me ofruar mësime më atraktive.

Refet Kalisi thekson:- është mirë me ua ndaluar telefonat nxënësve gjatë orarit mësimorë.

Hisni Luri thekson:- është e ndaluar me udhëzim administrativ dhe i kam raportet e drejtorëve të cilët e kanë komisionin për këtë çështje.

Hyriete Isufi thekson:- është mirë me bërë një ormanë që gjatë mëimit me i lënë telefonat sepse shumica e nxënësve janë të cilët i kanë prind në punë dhe nuk mundën me pasur kontakte në mes vete. Ka pasur raste që ua kemi marr dhe një javë nuk u kemi dhënë telefonat por përsëri e kanë vazhduar

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

6. Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik 2023/2027.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Majlinda Kaloshi thekson:- është një dokument lokal që e përcakton zhvillimin lokal, objektivat e së ardhmes dhe proceset e zhvillimit të projekteve gjithmonë duke u bazuar për një zhvillim afat gjatë për një periudhë të caktuar. Së bashku me shkresën ua kemi përcjell vendimin për grupin punues në përbërje në të cilin janë të përfshirë të gjitha palët e interesit duke u bazuar në udhëzimet administrative për hartimin e dokumenteve strategjike dhe janë përfshirë të gjitha grupet e interesit.

Resul Suma thekson:- a skish pas mundësi në këtë grup punues përveç drejtorëve të komunës dhe zyrtarëve të komunës me u përfshirë dikush edhe prej asamblesë komunale ose shefat e grupeve ose anëtarët e KPF-së. Është pak e pa arsyeshme dhe e pa logjikshme që formohet komisioni për hartimin e strategjisë për zhvillim ekonomik pa asambleista dhe nuk e di se kush ka me votuar këtë pikë të rendit të punës dhe shohë si të pa arsyeshme me votuar këtë pikë të rendit të punës.

Majlinda Kaloshi thekson:- sipas udhëzimit administrativ të gjitha palët e interesit duhet me qenë gjithë përfshirëse. Kuvendi i Komunës e ka miratuar listën për me u themeluar Komiteti për Zhvillim Ekonomik i cili sipas përgjegjëseve të planit të punës ka për qëllim ndihmesën dhe me qenë pjesë e këtyre grupeve punuese. Jemi konsultuar me Ministrinë përkatëse dhe kanë potencuar që kryesuesja e këtij komiteti mund të jetë edhe anëtare e komisionit. Dokumenti do të jetë në shqyrtim publik një muaj dhe keni mundësi me dhënë vërejtje dhe sugjerime të ndryshme.

Refet Kalisi thekson:- pajtohem me z. Resul Suma se a është e pa drejtë me qenë edhe shefat e grupeve parlamentare.

Majlinda Kaloshi thekson:- grupi punues nuk është i përbërë vetëm prej drejtorëve dhe ekzekutivit por ka përbërje edhe agjensione regjionale të cilat janë dhe persona të cilët janë adekuatë për hartimin e strategjive të ndryshme. Nuk është e kundërligjshme që me marr pjesë asamblastët në grupin punues por për shkak të numrit të madh prej pesëmbëdhjetë personave dhe ka qenë sfidë për me i mbledhur në takim . Jemi konsultuar me qendrën dhe pasi që Komitetit për Zhvillim Ekonomik është i themeluar prej Kuvendit të Komunës për anëtarë të grupit punues e kemi propozuar kryesuesen e këtij komiteti.

Kryesuesi thekson:-ke menduar që me na përfaqësuar përmes grupeve të tjera por ka më të rëndësishëm dhe nuk jam kundër askujt, as kundër drejtorëve nuk jam por nuk ka qenë patjetër të gjithë drejtorët me qenë në grup punues dhe nëse duhet me qenë drejtorët atëherë duhet të jemi edhe ne sepse nuk ka kuptim që na me u përfshirë me komitetin konsultativ dhe nuk është turp me potencuar që kemi harruar . Unë mendoj që shefat e grupeve parlamentare duhet të përfshihen në këtë komision.

Mehmet Ballazhi thekson:- nuk është problem numri i pjesëmarrësve ju mund ta shtoni numrin dhe ndoshta do të ishte një ndihmë më e madhe nëse do të ishte numri më shumë dhe nga ky moment mund të propozoni për anëtarë të komisionit edhe njëzet persona sepse sa më shumë faktorë pjesëmarrës në hartimin e strategjisë zhvillimore është më mirë për të gjithë. Ata të cilët i propozoni është mirë me marr pjesë dhe me dhënë kontributin e tyre për hartimin e kësaj strategjie.

Hyriete Isufi thekson:- e përkrah shefin e grupit parlamentar të PDK-së që të përfshihet së paku nga një përfaqësues prej subjekteve politike.

Sherif Berisha thekson:- e përkrah shefin e grupit parlamentar të PDK-së që është dashur të përfshihen në komision përfaqësuesit edhe prej Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 13 kundër, 1 abstenim.

7.Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Refet Kalisi thekson:- mbikalimi te hekurudha është i ndriçuar por nuk ka drita dhe duhet të rregullohet. Kur fillon pagesa e ujit duhet ta dinë qytetarët.

Zaim Bela thekson:- nga drejtorja e financave me u bërë një listë për punëtorët të cilët punojnë në Institucione Publike dhe kanë borxhe në tatim në pronë me u bërë lista publike nëse lejohet . Për mbledhje të radhës me një dërguar.

Arsim Dernjani thekson:- me përfaqësuesit e kompanisë “Bifurkacioni” e kemi diskutuar këtë çështje dhe në momentin që do të vendosen orët në Han të Elezit gjithçka do të fillon prej zeros.

Lindita Ballazhi thekson:- do ta shqyrtojmë se a ka bazë ligjore se sa ka të drejtë dikush ta dijë për një qytetarë se sa ka borxh në tatim në pronë .

Xhevahir Dernjani thekson:- projekti te shkollë është pasqyrë për të gjithë ata që kalojnë aty por vazhdon për vitin 2025 dhe është mirë me u bërë sepse është pasqyrë më shumë për shkollën. Prej qendrës tregtare ETC e deri te varrezat e Lokëve është mirë me u mbjell drunj dekorativë . Për rrugën e fshatit Paldenicë duhet që të hartohet një projekt sepse lidhet pjesa e Vërtomicës si fshat.

Resul Suma thekson:- qeveria ka shpallur konkurs për pranimin e regjistrimit të popullsisë dhe cili zyrtarë ka me qenë në komunë për me ju ndihmuar atyre për me aplikuar dhe a është kusht që patjetër me qenë i pa punë.

Erblin Meliqi thekson:- është vendosur pasqyra rrugore dhe është mirë me rregulluar më mirë. Banorët e lagjes Brava kanë kërkuar shtrimin e ndriçimit publikë edhe me një pjesë po ashtu probleme kanë edhe me shtyllat elektrike.

Sherif Berisha thekson:- përgjigjet që i kam kërkuar nuk i kam pranuar dhe kanë kaluar të gjitha afatet por nuk e di pse nuk i kanë dërguar.

Hyrijete Isufi thekson:- ku ka mbërri çështja e testimit të ujit.

Arsim Dernjani thekson:-do të rregullohet çështja e pasqyrave. Kompania është në teren duke i kryer punimet dhe vendosja e pushtave po ju merr kohë.

Natyrja Kalisi thekson:-prej komunës sonë do të jenë 18 regjistruar dhe katër mbikëqyrës . Aplikimi është i hapur dhe janë dy forma të aplikimit onllajn dhe fizikë. Komisioni është themeluar ashtu siç e ka kërkuar Qeveria.


Refet Kalisi thekson:- sa biznese e kanë kryer pagesën dhe sa prej tyre i kanë borxh komunës që nuk e kanë kryer pagesën.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:43.

Procesmbajtësi
Ayta Bushi





REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



Nr. 04/ 8564 /2023

DATA :	10.10.2023
PËR :	KPF dhe Kuvend Komunal
CC:	Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit
NGA :	Lindita Ballazhi Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
LËNDA :	Raporti financiar për periudhën janar-shtator 2023

Të nderuar,

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të dispozitave të nenit 45, paragrafët 45.2 dhe 45.4, si dhe të Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, të nenit 51, paragrafi 5, gjeni të bashkangjitur raportin financiar për periudhën janar-shtator 2023.

Me respekt,



Republika e Kosovës - Republic of Kosova
Komuna – Municipality



Nr. 04/8564/2023

Data: 10.10.2023

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

RAPORT FINANCIAR PËR PERIUDHËN JANAR-SHTATOR 2023

HANI I ELEZIT, Tetor 2023

Hyrje

Raporti financiar për periudhën janar - shtator 2023, është përgatitur në bazë të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të dispozitave të nenit 45, paragrafët 45.2 dhe 45.4, si dhe statutin e komunës së Hanit të Elezit të nenit 51, paragrafi 5.

Ky raport përmban një përmbledhje të trendeve kryesore të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore përgjatë periudhës nëntë mujore të vitit 2023. Raporti përmban analiza përmbledhëse të periudhës përkatëse, pasqyron të hyrat sipas drejtorive, sipas llojit të të hyrave si dhe krahasimet me periudhat paraprake dhe projektionet buxhetore.

Performanca e të hyrave

Të hyrat vetanake: gjatë nëntë mujorit të vitit 2023, të hyrat janë realizuar në shumë prej 292,919.35 € dhe paraqesin 52.2 % të të hyrave të përgjithshme të planifikuara vjetore, ndërsa krahasuar me realizimin e nëntë mujorit të vitit paraprak 2022 kemi një rritje prej 28,490.13 €.

Performanca e shpenzimeve

Shpenzimet buxhetore: gjatë nëntë mujorit të vitit 2023 pagesat totale janë në shumë prej 2,125,165.24 € dhe paraqesin 63.46 % të shpenzimeve të përgjithshme të planifikuara, ndërsa krahasuar me shpenzimin e nëntë mujorit të vitit paraprak kemi një rritje prej prej 420,886.62 € .

Shpenzimet për paga dhe shtesa shënuan vlerën prej 1,502,955.67 € gjatë këtij nëntë mujori, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 88.26 % krahasuar me vlerën totale të buxhetuar për këtë kategori. Shpenzimet për paga dhe shtesa gjatë periudhës raportuese paraqesin një rritje prej 28.65 % apo për 334,681.44 € më shumë krahasuar me shpenzimet e pagave dhe shtesave për periudhën e njëjtë të vitit 2022.

Shpenzimet për mallra dhe shërbime shënuan vlerën prej 312,224.88 € gjatë këtij nëntë mujori, duke arritur kështu normën e ekzekutimit 67.14%, krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori. Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi një rritje prej 44.25% ose për 95,774.66 € më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022.

Shërbimet komunale shënuan vlerën prej 56,644.21 € duke arritur kështu normën e ekzekutimit 58.69 % krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori. Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi një rritje prej 29.95% apo 13,054.94 € më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022.

Shpenzimet për subvencione dhe transfere arritën shumën prej 64,008.08€ duke arritur kështu normën e ekzekutimit 64.00% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori. Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi një rënie për 5.38 % apo 3,641.92 € më pak krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022.

Shpenzimet kapitale arritën vlerën prej 189,732.40 € që paraqet normën e ekzekutimit në 19.25% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori. Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi një rënie për 9.09% apo 18,982.50 € më pak krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022.

BUXHETI KOMUNAL 2023

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2023 është në lartësi prej **3,349,715.00Euro**.

Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim:

- Paga dhe shtesa.....1,702,823.00 €,
- Mallra dhe shërbime.....465,000.00€,
- Shpenzimet komunale96,500.00€,
- Subvencione dhe transfere... 100,000.00€,
- Shpenzime kapitale985,392.00€,
- Totali i buxhetit.....**3,349,715.00** €.

Ndërsa buxheti përfundimtarë është **3,523,685.91 €**, ku në këtë shumë përfshihen:

1. Bartja e të hyrave vetanake të pa shpenzuara të vitit 2021 dhe 2022 në vlerë prej **125,257.43€**,
2. Donacion prej Qeverisë Japoneze për projektin “Ndërtimi aneksit për këmbësor në urën e Seçishtës” në vlerë prej **43,809.40 €**,
3. Mjete të mbetura nga Grante të cilat janë bartur vit pas viti në vlerë prej **3,014.43 €**.

Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar-shtator 2023 është në shumë prej **2,125,565.24 € apo 63.46 %**.

KRAHASIMI I PAGESAVE PËR PERIUDHËN JANAR-SHTATOR 2023/2022

Kategoritë ekonomike të shpenzimeve	Buxheti 2023	Realizimi Janar-Shtator 2023	%	Buxheti 2022	Realizimi Janar-Shtator 2022	%	Krahasimi në euro 2023/22	Krahasimi në % 2023/22
Paga dhe shtesa	1,702,823.00	1,502,955.67	88.26%	1,756,083.00	1,168,274.23	66.53%	334,681.44	28.65
Mallra dhe shërbime	465,000.00	312,224.88	67.14%	385,975.00	216,450.22	56.08%	95,774.66	44.25
Shpenzime komunale	96,500.00	56,644.21	58.69%	67,700.00	43,589.27	64.39%	13,054.94	29.95
Subvencione dhe trans.	100,000.00	64,008.08	64.00%	80,000.00	67,650.00	84.56%	(3,641.92)	(5.38)
Shpenzime kapitale	985,392.00	189,732.40	19.25%	455,000.00	208,714.90	45.87%	(18,982.50)	(9.09)
Rezervat	-	-	0.00%	15,000.00	-	0.00%	-	
TOTALI	3,349,715.00	2,125,565.24	63.46%	2,759,758.00	1,704,678.62	61.77%	420,886.62	24.69

Komente dhe shpjegime:

- Shpenzimet buxhetore:** gjatë nëntë mujorit të vitit 2023 pagesat totale janë në shumë prej 2,125,165.24 € dhe paraqesin 63.46 % të shpenzimeve të përgjithshme të planifikuara, ndërsa krahasuar me shpenzimin e nëntë mujorit të vitit paraprak kemi një rritje prej prej 420,886.62 € .
- Shpenzimet për paga dhe shtesa** shënuan vlerën prej 1,502,955.67 € gjatë këtij nëntë mujori, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 88.26 % krahasuar me vlerën totale të buxhetuar për këtë kategori. Shpenzimet për paga dhe shtesa gjatë periudhës raportuese paraqesin një rritje prej 28.65 % apo për 334,681.44 € më shumë krahasuar me shpenzimet e pagave dhe shtesave për periudhën e njëjtë të vitit 2022.
- Shpenzimet për mallra dhe shërbime** shënuan vlerën prej 312,224.88 € gjatë këtij nëntë mujori, duke arritur kështu normën e ekzekutimit 67.14%, krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori. Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi një rritje prej 44.25% ose për 95,774.66 € më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022.
- Shërbimet komunale** shënuan vlerën prej 56,644.21 € duke arritur kështu normën e ekzekutimit 58.69% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori. Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi një rritje prej 29.95% apo 13,054.94 € më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022.

5. **Shpenzimet për subvencione dhe transfere** arritën shumën prej 64,008.08€ duke arritur kështu normën e ekzekutimit 64.00% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori. Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi një rënie për 5.38 % apo 3,641.92 € më pak krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022.

6. **Shpenzimet kapitale** arritën vlerën prej 189,732.40 € që paraqet normën e ekzekutimit në 19.25 % krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori. Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi një rënie për 9.09% apo 18,982.50 € më pak krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022.

BUXHETI I KOMUNËS SIPAS DREJTORIVE DHE KATEGORIVE EKONOMIKE

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Allocated	E paalokuar	Aktuali	Zotim /Obligimet në pritje	Buxheti FreeBalance	Alokimi Suficid/Deficid
CAT / RESP / PCLASS / SUBCL	A	B	A - B	C	D	A - (C + D)	A - E
10 BUXHETI	2,791,483.65	2,583,134.86	208,348.79	1,972,588.36	327,535.96	491,359.33	2,791,483.65
659 HANI I ELEZIT	2,791,483.65	2,583,134.86	208,348.79	1,972,588.36	327,535.96	491,359.33	2,791,483.65
16035 ZYRA E KRYETARIT - HANI I ELEZIT	103,011.99	98,723.98	4,288.01	86,695.22	20.28	16,296.49	103,011.99
11 PAGA DHE SHTESA	78,011.99	73,723.98	4,288.01	67,325.55	0.00	10,686.44	78,011.99
13 MALLRA DHE SHËRBIME	25,000.00	25,000.00	0.00	19,369.67	20.28	5,610.05	25,000.00
16335 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	218,130.00	204,478.31	13,651.69	156,931.44	15,694.18	45,504.38	218,130.00
11 PAGA DHE SHTESA	93,130.00	79,478.31	13,651.69	71,573.70	0.00	21,556.30	93,130.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	65,000.00	65,000.00	0.00	45,402.33	15,610.40	3,987.27	65,000.00
14 SHPENZIME KOMUNALE	60,000.00	60,000.00	0.00	39,955.41	83.78	19,960.81	60,000.00
16935 ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL - HANI I ELEZIT	76,719.00	76,719.00	0.00	99,542.76	0.00	-22,823.76	76,719.00
11 PAGA DHE SHTESA	61,719.00	61,719.00	0.00	91,794.18	0.00	-30,075.18	61,719.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	15,000.00	15,000.00	0.00	7,748.58	0.00	7,251.42	15,000.00
17535 BUXHETI - HANI ELEZIT	59,600.99	52,252.47	7,348.52	48,089.93	11.04	11,500.02	59,600.99
11 PAGA DHE SHTESA	54,600.99	47,252.47	7,348.52	43,260.49	0.00	11,340.50	54,600.99
13 MALLRA DHE SHËRBIME	5,000.00	5,000.00	0.00	4,829.44	11.04	159.52	5,000.00
18444 PARANDALIMI DHE INSPEKTIMI I ZJARRIT	176,389.00	166,835.54	9,553.46	144,567.94	6,132.79	25,688.27	176,389.00
11 PAGA DHE SHTESA	66,389.00	56,835.54	9,553.46	53,856.37	0.00	12,532.63	66,389.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	60,000.00	60,000.00	0.00	51,995.58	0.03	8,004.39	60,000.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	50,000.00	50,000.00	0.00	38,715.99	6,132.76	5,151.25	50,000.00
19675 ZYRA LOKALE E KOMUNITETEVE - HANI I ELEZIT	6,826.99	6,190.69	636.30	5,604.33	0.00	1,222.66	6,826.99
11 PAGA DHE SHTESA	6,326.99	5,690.69	636.30	5,104.33	0.00	1,222.66	6,326.99
13 MALLRA DHE SHËRBIME	500.00	500.00	0.00	500.00	0.00	0.00	500.00
47115 PYLLTARIA INSPEKSIONI - HANI I ELEZIT	32,438.00	29,698.76	2,739.24	26,169.50	902.00	5,366.50	32,438.00
11 PAGA DHE SHTESA	28,938.00	26,198.76	2,739.24	23,971.50	0.00	4,966.50	28,938.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	3,500.00	3,500.00	0.00	2,198.00	902.00	400.00	3,500.00
48035 PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK - HANI ELEZIT	24,544.00	23,623.52	920.48	21,864.44	0.00	2,679.56	24,544.00
11 PAGA DHE SHTESA	21,544.00	20,623.52	920.48	18,864.44	0.00	2,679.56	21,544.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	3,000.00	3,000.00	0.00	3,000.00	0.00	0.00	3,000.00
66480 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - HANI ELEZIT	439,706.99	392,647.32	47,059.67	131,451.73	170,787.36	137,467.90	439,706.99
11 PAGA DHE SHTESA	56,276.99	54,688.32	1,588.67	49,390.63	0.00	6,886.36	56,276.99
13 MALLRA DHE SHËRBIME	14,959.00	14,959.00	0.00	12,044.28	449.46	2,465.26	14,959.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	368,471.00	323,000.00	45,471.00	70,016.82	170,337.90	128,116.28	368,471.00
73044 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	16,584.00	16,584.00	0.00	14,845.02	0.00	1,738.98	16,584.00
11 PAGA DHE SHTESA	16,084.00	16,084.00	0.00	14,845.02	0.00	1,238.98	16,084.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	500.00	500.00	0.00	0.00	0.00	500.00	500.00
75050 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - HANI I ELEZIT	366,451.05	314,579.42	51,871.63	237,505.89	47,050.02	81,895.14	366,451.05

11 PAGA DHE SHTESA	251,951.05	204,579.42	47,371.63	187,046.20	0.00	64,904.85	251,951.05
13 MALLRA DHE SHËRBIME	70,000.00	70,000.00	0.00	43,249.50	21,959.02	4,791.48	70,000.00
14 SHPENZIME KOMUNALE	14,500.00	14,500.00	0.00	7,210.19	91.00	7,198.81	14,500.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	30,000.00	25,500.00	4,500.00	0.00	25,000.00	5,000.00	30,000.00
75671 SHËRBIMET SOCIALE - HANI ELEZIT	23,527.99	21,695.80	1,832.19	18,756.15	127.02	4,644.82	23,527.99
11 PAGA DHE SHTESA	19,727.99	17,895.80	1,832.19	16,667.56	0.00	3,060.43	19,727.99
13 MALLRA DHE SHËRBIME	2,800.00	2,800.00	0.00	1,633.22	15.00	1,151.78	2,800.00
14 SHPENZIME KOMUNALE	1,000.00	1,000.00	0.00	455.37	112.02	432.61	1,000.00
92175 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	99,900.67	99,900.67	0.00	82,648.36	2,042.50	15,209.81	99,900.67
11 PAGA DHE SHTESA	32,900.67	32,900.67	0.00	29,834.23	0.00	3,066.44	32,900.67
13 MALLRA DHE SHËRBIME	52,000.00	52,000.00	0.00	37,814.14	2,042.49	12,143.37	52,000.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	15,000.00	15,000.00	0.00	14,999.99	0.01	0.00	15,000.00
92890 ARSIMI PARAFILLOR DHE ÇERDHET - HANI I ELEZIT	76,582.99	74,577.44	2,005.55	67,045.73	431.01	9,106.25	76,582.99
11 PAGA DHE SHTESA	63,332.99	61,327.44	2,005.55	58,455.42	0.00	4,877.57	63,332.99
13 MALLRA DHE SHËRBIME	10,250.00	10,250.00	0.00	7,181.70	430.01	2,638.29	10,250.00
14 SHPENZIME KOMUNALE	3,000.00	3,000.00	0.00	1,408.61	1.00	1,590.39	3,000.00
94020 ARSIMI FILLOR - HANI ELEZIT	901,612.00	873,053.35	28,558.65	716,357.63	80,325.76	104,928.61	901,612.00
11 PAGA DHE SHTESA	695,699.00	695,699.00	0.00	661,048.13	0.00	34,650.87	695,699.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	78,413.00	78,413.00	0.00	49,580.47	25,325.76	3,506.77	78,413.00
14 SHPENZIME KOMUNALE	14,500.00	14,500.00	0.00	5,729.03	0.00	8,770.97	14,500.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	113,000.00	84,441.35	28,558.65	0.00	55,000.00	58,000.00	113,000.00
95220 ARSIMI I MESËM - HANI I ELEZIT	169,457.99	131,574.59	37,883.40	114,512.29	4,012.00	50,933.70	169,457.99
11 PAGA DHE SHTESA	158,079.99	120,196.59	37,883.40	109,917.92	0.00	48,162.07	158,079.99
13 MALLRA DHE SHËRBIME	7,878.00	7,878.00	0.00	2,708.77	4,012.00	1,157.23	7,878.00
14 SHPENZIME KOMUNALE	3,500.00	3,500.00	0.00	1,885.60	0.00	1,614.40	3,500.00
21 TE HYRAT VETANAKE	560,121.00	216,257.15	343,863.85	117,427.78	42,351.93	400,341.29	560,121.00
659 HANI I ELEZIT	560,121.00	216,257.15	343,863.85	117,427.78	42,351.93	400,341.29	560,121.00
16035 ZYRA E KRYETARIT - HANI I ELEZIT	47,500.00	40,000.00	7,500.00	39,068.08	0.00	8,431.92	47,500.00
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	47,500.00	40,000.00	7,500.00	39,068.08	0.00	8,431.92	47,500.00
16335 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	15,000.00	15,000.00	0.00	12,365.46	2,499.13	135.41	15,000.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	15,000.00	15,000.00	0.00	12,365.46	2,499.13	135.41	15,000.00
18444 PARANDALIMI DHE INSPEKTIMI I ZJARRIT	35,000.00	30,000.00	5,000.00	18,469.84	2,401.30	14,128.86	35,000.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	15,000.00	15,000.00	0.00	9,581.14	0.00	5,418.86	15,000.00
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	15,000.00	10,000.00	5,000.00	6,290.00	0.00	8,710.00	15,000.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	5,000.00	5,000.00	0.00	2,598.70	2,401.30	0.00	5,000.00
47115 PYLLTARIA INSPEKSIONI - HANI I ELEZIT	11,500.00	0.00	11,500.00	0.00	0.00	11,500.00	11,500.00
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	11,500.00	0.00	11,500.00	0.00	0.00	11,500.00	11,500.00
66480 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - HANI ELEZIT	327,530.00	89,382.35	238,147.65	19,899.92	37,385.64	270,244.44	327,530.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	6,000.00	0.00	6,000.00	0.00	0.00	6,000.00	6,000.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	321,530.00	89,382.35	232,147.65	19,899.92	37,385.64	264,244.44	321,530.00
75050 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - HANI I ELEZIT	6,460.00	1,559.00	4,901.00	0.00	0.00	6,460.00	6,460.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	6,460.00	1,559.00	4,901.00	0.00	0.00	6,460.00	6,460.00
75671 SHËRBIMET SOCIALE - HANI ELEZIT	200.00	108.00	92.00	0.00	0.00	200.00	200.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	200.00	108.00	92.00	0.00	0.00	200.00	200.00

92175 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	31,000.00	21,603.00	9,397.00	21,344.00	0.00	9,656.00	31,000.00
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	26,000.00	20,000.00	6,000.00	19,750.00	0.00	6,250.00	26,000.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	5,000.00	1,603.00	3,397.00	1,594.00	0.00	3,406.00	5,000.00
92890 ARSIMI PARAFILLOR DHE ÇERDHET - HANI I ELEZIT	8,540.00	7,325.00	1,215.00	6,280.48	65.86	2,193.66	8,540.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	8,540.00	7,325.00	1,215.00	6,280.48	65.86	2,193.66	8,540.00
94020 ARSIMI FILLOR - HANI ELEZIT	77,391.00	11,279.80	66,111.20	0.00	0.00	77,391.00	77,391.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	77,391.00	11,279.80	66,111.20	0.00	0.00	77,391.00	77,391.00
22 TË HYRAT VETANAKE NGA VITI I KALUAR	125,257.43	125,257.43	0.00	37,470.34	28,486.20	59,300.89	125,257.43
659 HANI I ELEZIT	125,257.43	125,257.43	0.00	37,470.34	28,486.20	59,300.89	125,257.43
16035 ZYRA E KRYETARIT - HANI I ELEZIT	1,033.00	1,033.00	0.00	0.00	0.00	1,033.00	1,033.00
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	1,033.00	1,033.00	0.00	0.00	0.00	1,033.00	1,033.00
16335 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	62.14	62.14	0.00	55.00	0.00	7.14	62.14
13 MALLRA DHE SHËRBIME	62.14	62.14	0.00	55.00	0.00	7.14	62.14
18444 PARANDALIMI DHE INSPEKTIMI I ZJARRIT	19,000.00	19,000.00	0.00	8,999.99	0.01	10,000.00	19,000.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	19,000.00	19,000.00	0.00	8,999.99	0.01	10,000.00	19,000.00
66480 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - HANI ELEZIT	86,657.74	86,657.74	0.00	25,000.00	24,840.17	36,817.57	86,657.74
30 PASURITË JOFINANCIARE	86,657.74	86,657.74	0.00	25,000.00	24,840.17	36,817.57	86,657.74
75050 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - HANI I ELEZIT	8,275.02	8,275.02	0.00	3,359.35	0.02	4,915.65	8,275.02
13 MALLRA DHE SHËRBIME	4,965.54	4,965.54	0.00	3,359.35	0.02	1,606.17	4,965.54
30 PASURITË JOFINANCIARE	3,309.48	3,309.48	0.00	0.00	0.00	3,309.48	3,309.48
92890 ARSIMI PARAFILLOR DHE ÇERDHET - HANI I ELEZIT	3,773.33	3,773.33	0.00	56.00	3,646.00	71.33	3,773.33
13 MALLRA DHE SHËRBIME	3,773.33	3,773.33	0.00	56.00	3,646.00	71.33	3,773.33
94020 ARSIMI FILLOR - HANI ELEZIT	6,456.20	6,456.20	0.00	0.00	0.00	6,456.20	6,456.20
30 PASURITË JOFINANCIARE	6,456.20	6,456.20	0.00	0.00	0.00	6,456.20	6,456.20
32 GRANTE TJERA TE JASHTME	30.00	30.00	0.00	0.00	0.00	30.00	30.00
659 HANI I ELEZIT	30.00	30.00	0.00	0.00	0.00	30.00	30.00
66480 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - HANI ELEZIT	30.00	30.00	0.00	0.00	0.00	30.00	30.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	30.00	30.00	0.00	0.00	0.00	30.00	30.00
49 EU-UNIONI EUROPIAN	2,984.43	2,984.43	0.00	0.00	0.00	2,984.43	2,984.43
659 HANI I ELEZIT	2,984.43	2,984.43	0.00	0.00	0.00	2,984.43	2,984.43
66480 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - HANI ELEZIT	2,984.43	2,984.43	0.00	0.00	0.00	2,984.43	2,984.43
13 MALLRA DHE SHËRBIME	2,984.43	2,984.43	0.00	0.00	0.00	2,984.43	2,984.43
59 QEVERIA JAPONEZE	43,809.40	43,809.40	0.00	27,885.99	0.01	15,923.40	43,809.40
Totali I Planifikuar					148,182.45

Mallra dhe shërbime

Mallrat dhe shërbimet do ti paraqesim përmes tabelës

Përshkrimi	Shuma
Shpenzime për karburant	27000
Shpenzimet e deponise (KMDK)	23000
Shpenzimet e mirëmbajtjes së mjeteve	15000
Shpenzimet e sigurimit dhe regjistrimit	6000
Shpenzime për internet	130
Shpenzime për rrymë	1500
Shpenzime për telefon	1200
Shpenzime të reprezentacionit	1500
Shpenzime për pajisje pune	10000
Kompjuter dhe pajisje teknologjike	3000
Inventar për zyrë	1200
Shpenzime për trajnime	1500
Licencë për program faturimi	1500
Shpenzime për zyrë	2500
Totali i Planifikuar	95030

Tatimet

NPL PASTRIMI paguan tre lloje të tatimeve dhe planifikimi i shpenzimeve për tatime paraqitet përmes tabelës:

Përshkrimi	Shuma
Tatimi i Vlerës së Shtuar (TVSH)	12000
Këstet tremujore për Korporata TM	1500
Tatimi në Fitim CD	2500
Totali i Planifikuar	16000

Blerjet Kapitale

Nenkuptojnë blerje përasete të mjeteve si pjesë shtesë e mjeteve si: luge e për pastrimin e bores, kamionetë, hedhëse e kryes apo diçka që i nevojitet mjeteve.

Blerje Kapitale/ Fitim i Realizuar	Shuma
Asete për mjete	28927.95
Totali i Planifikuar	28927.95

13. Strategjia Promovuese

Aktiviteti Promovimit	Kostoja ne Euro	Afatikohorë dhe personi përgjegjës
Faqjazyrtare e Komunes	0	Pa afatëcaktuar – Mehmet Ballazhi
Facebook - Faqjazyrtare NPL	0	Pa afatëcaktuar – Hirman Kuka

14. Rishikimi i rregulloreve të menaxhimit të mbeturinave

Dispozitat që rregullojnë menaxhimin e mbeturinave në Hanin e Elezit janë të përfshira në Rregulloren për Mbrojtjen e Mjedisit, të cilat janë miratuar nga Kuvendi Komunal (KK).

Rregullorja aktuale për mbrojtjen e mjedisit nuk përfshin detyrimin e gjeneruesve të mbeturinave për të paguar për shërbimin e mbledhjes dhe asgjësimit të mbeturinave. Për këtë arsye NPL planifikon të rishikojë në mënyrë kritike rregulloren aktuale dhe do të propozojë te Kuvendi Komunal (KK) për përfshirjen e detyrimit të gjeneruesve të mbeturinave për të paguar tarifën e cila do të vendoset nga KK-ja dhe rishikuar në baza vjetore. Ajo do të propozon se mos-pagesa e taksës do të dënohet me gjobë.

15. Zbatimi

Pas miratimit të rishikimit, NPL do të fillojë zbatimin e dispozitave të menaxhimit të mbeturinave në rregulloren për mbrojtjen e mjedisit, si dhe të Ligjit për mbeturina. Theksi i

zbatimit do të vendoset në pagesën e tarifës për menaxhimin e mbeturinave. Ata që i shmangen pagesës do të identifikohen duke krahasuar regjistrin e amvisërive dhe regjistrin e biznesit me faturën e lëshuar për pagesën e tarifës së menaxhimit të mbeturinave. Ata që nuk paguajnë do të vizitohen nga një inkasant i tarifave i cili në radhë të parë do të mbledhë vetëm tarifën dhe do të ofroj informata për shkaqet dhe nevojën e pagesës së tarifës për menaxhimin e mbeturinave. Në rast të shmangies së zgjatur të pagesës dhe në rast të përsëritjes së shkeljes, inspektori përgjegjës për mjedisin do të shoqërojë inkasantin e tarifave dhe do të vendosë një gjobë mbi tarifën për grumbullimin e mbeturinave. Në një fazë të mëvonshme dhe një tarifë shtesë të mbledhjes së mbeturinave do të futet. Përveç kësaj aktivitetet e zbatimit do të synojnë parandalimin e largimit të paligjshëm të mbeturinave në komunë dhe rikuperimin e kostove të largimit të mbeturinave të paligjshme të deponuara nga kundërvajtësit. Nëse kërkohet, shkelësit do të merren në gjykatë. Megjithatë, aktivitetet e zbatimit do të kryhen vetëm në zonat e komunës, ku ofrohen shërbimet e mbledhjes së mbeturinave. Aktivitetet e zbatimit në fshatrat ku mbeturinat aktualisht nuk mbledhen do të nisin vetëm pas futjes së shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave dhe kryerjen e një fushate të ndërgjegjësimit publik. Përpara nisjes së mbledhjes së mbeturinave, gjeneruesit e mbeturinave do të inkurajohen që të transferojnë mbeturinat e tyre në një kontejner publik në qytetin e Hanit të Elezit

Hyrja në fuqi

Ky Biznes Plan hynë në fuqi 8 ditë nga dita e nënshkrimit. **Anëtarët e Bordit të Drejtorëve**


Albulena Ballazhi – Kryesuesee Bordit, Hani i Elezit, Nënshkrimi _____

Nazmi Suma – Anëtar i bordit, Hani i Elezit, Nënshkrimi _____

Fahri Bushi – Anëtar i bordit, Hani i Elezit, Nënshkrimi _____

Laura Bushi – Anëtar i bordit, Hani i Elezit, Nënshkrimi _____

16. ORGANOGRAMI I PROPOZUAR I STRUKTURËS ORGANIZATIVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE PËR MBETURINA NPL "PASTRIMI" SH.A, HANI I ELEZIT





Komuna Hani i Elezit

PLANI I VEPRIMIT PËR PARANDALIMIN E DHUNËS NË FAMILJE - MEKANIZMIT (2024 – 2026)

Tetor 2023

Lajmërimi i rasteve të dhunës në familje

Kontaktet:

Policia e Kosovës – Hani i Elezit - 192

Qendra për Punë Sociale – Hani i Elezit – 03820046571

Thirrjet emergjente - 122

Falënderim

Hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje ishte përpjekje e përbashkët e Grupit Punës për hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, nën koordinimit të kordinatorit të Mekanizmit Kundër Dhunës në Familje në Han të Elezit, me përkrahjen e misionit të OSBE në Kosovë dhe një spektri të gjërë të partnerëve.

Komuna e Hanit të Elezit gjithashtu vlerëson lartë punën dhe përkushtimin e zyrtarëve në kuadër të ZBGJ, QKMF, QPS, OJQ-ve, Gjykatën dega në Kaçanik, Policia e Kosovës, Strehimores “Shtëpia Ime”, po ashtu, falënderon veçanërisht institucionet komunale (drejtoritë komunale) për kontributin që kanë treguar dhe OSBE për mbështetje.

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje është një prej dokumenteve më të rëndësishme të Komunës së Hanit të Elezit, hartimi i së cilës ka ndjekur një proces të gjatë diskutimesh dhe kontributesh konkrete të shumë institucioneve relevante që punojnë në këtë fushë. Përfshirja dhe kontributi i tyre kanë dhënë frytin e punës që gjendet në faqet e këtij dokumenti për parandalimin e dhunës në familje në komunën tonë.

Shkurtesat:

BE - Bashkimi Evropian

DKA – Drejtoria Komunale e Arsimit

DHBGJ - Dhuna në Baza Gjinore

DHF - Dhuna në familje

MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MM - Memorandum mirëkuptimi

MV - Mbrojtës i Viktimave

OJQ - Organizata Joqeveritare

OSBE - Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë

PK – Policia e Kosovës

PSV - Procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje

QAP - Qendra e aftësimit profesional

QMF – Qendra e Mjekësisë Familjare – Hani i Elezit

QPS - Qendrat për Punë Sociale – Hani i Elezit

KBI – Kshilli i Bashkësisë Islame – Hani i Elezit

QRK – Qeveria e Republikës së Kosovës

UA - Udhëzim Administrativ

ZKBGJ - Zyrtarët Komunalë për Barazi Gjinore

ZPK – Zyra e Punësimit – Hani i Elezit

Përmbajtja

I. Përmbledhje ekzekutive

II. Hyrja

III. Metodologjia

IV Sfondi –Analiza e gjendjes

4.1. Analiza e përgjithshme e situatës së dhunës në familje

4.2. Analiza e situatës së dhunës në familje në Komunë

4.3. Pasojat më të theksuara të dhunës në familje

V. Objektivat Strategjike

VI. Plani i Veprimit

VII. Aranzhimet e zbatimit, monitorimit dhe raportimit

7.1. Mekanizmat zbatues

7.2. Mekanizmat monitorues dhe raportues

I. Përmbledhje ekzekutive

Dhuna në familje është vepër penale¹ dhe fenomen që lëkund vlerat e shoqërisë demokratike. Kushtetuta e Republikës së Kosovës² në kuadër të parimeve të saj, mbrohet dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke i konsideruar ato si të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme.

Me qëllim të parandalimit dhe ngritjes së efikasitetit të trajtimit të rasteve të dhunës në familje, duke synuar plotësimin e standardeve për ofrimin e mbrojtjes së duhur viktimave të dhunës në familje, në pajtim me Konventën e Stambollit, është hartuar Ligji për Mbrojtje nga dhuna në familje, që “dhunën në familje”³ e përkufizon: “veprim apo mosveprim i qëllimshëm që rezulton me abuzim, kur kryhet nga një person që është apo ka qenë në marrëdhënie familjare me viktimën”.

Duke u bazuar në obligimet që rrjedhin nga korniza ligjore dhe standardet ndërkombëtare, mbështetur në masë të gjerë në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje/politikat nacionale dhe Programin e Kosovës për Barazi Gjinore (2020 – 2024), që njëherit paraqet një vazhdimësi logjike të përkushtimit të institucioneve qeveritare për një zgjidhje funksionale dhe efektive për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje dhe eliminimin e pabarazive e shtrirë në nivel lokal, Kuvendi Komunal i Hanit të Elezit nën koordinimin e Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, me përkrahjen e OSBE në Kosovë ka hartuar “Strategjinë Komunale dhe Planin e Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje”.

Duke dënuar të gjitha format⁴ e dhunës në familje dhe bazuar në jetësimin e parimit të Kartës së Kombeve të Bashkuara “*Të drejta të barabarta për burrat dhe gratë*”⁵, strategjia është e përqendruar në fuqizimin dhe funksionalizimin e Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, në përputhje me përgjegjësitë e tyre të përcaktuara në kuadër të

¹ Kodi nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 248;

² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli II;

³ Ligji nr. 03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje, Kuvendi i Kosovës, neni 2.1(1.1): E definon si të tillë mes personave që janë/kanë qenë: të fejuar, të martuar; në bashkësi jashtëmartesore; bashkëjetojnë në ekonomi të përbashkët, si dhe përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martesë, adoptimi, krushqie apo janë në lidhje kujdestarie, duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat, vëllezërit dhe motrat, hallat e tezë, xhaxhallarët e dajallarët ose kushërinjtë, janë prindër të një fëmije të përbashkët, janë palë procedurale në një kontest nga marrëdhëniet familjare: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-182-eng.pdf> 2;

⁴ Dhuna në familje, dhuna fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike, për nevojat e kësaj strategjie do të jetë e njëjtë siç është përkufizuar në dispozitën e nenit 2, nën paragrafi 1.2. të Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje;

⁵ OKB, Karta e Kombeve të Bashkuara, neni 1, 1945;

Marrëveshjes së Mirëkuptimit⁶, kornizës ligjore në fuqi dhe obligimeve që rrjedhin nga Konventa e Stambollit për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, duke synuar rritjen e koordinimit efektiv dhe bashkërendimin e veprimeve në minimizimin e fenomenit të dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimës së dhunës.

Synim ky që parashihet të realizohet duke adresuar me prioritet fushat e veprimit të strategjisë:

#Përmirësimi i sistemit institucional për parandalim dhe ofrim të shërbimeve cilësore për mbrojtje nga dhuna në familje;

Përmirësimi i qeverisjes lokale për parandalimin dhe mbrojtje nga dhuna në familje;

Fuqizimi i shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese të viktimave të dhunë në familje;

Qasja strategjike e të cilit është që me anë të objektivave të qarta dhe aktiviteteve specifike, të ndihmojë Mekanizmin Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në fuqizimin e tyre për përmbushjen e përgjegjësiwe institucionale karshi institucioneve qe përfaqësojnë në këtë trup institucional dhe përgjegjësiwe që rrjedhin themelimi i tyre. Njëherit, kërkon sigurimin e zbatimit të kornizës ligjore, politikave nacionale dhe standardeve ndërkombëtare për parandalimin, identifikimin pro-aktiv dhe luftimin e dhunës në familje, si dhe reagimit të menjëhershëm dhe të vazhdueshëm në ofrimin e shërbimeve cilësore për mbrojtje dhe trajtim të rasteve të dhunës në familje. Po ashtu, synon që duke marrë masa efektive në rritjen e koordinimit dhe bashkërendimit të veprimeve në mes të akterëve relevantë, të nxitet përparimi shoqëror ku shoqëria është e vetëdijshme dhe mbështetëse e të drejtave të njeriut për të qenë të lirë nga të gjitha format e dhunës që promovon fuqizimin social dhe ekonomik të vajzave dhe grave dhe dhuna në familje të bëhet e papranueshme në komunitetin tonë.

Bazuar në frymën e Konventës së Stambollit që pranon se dhuna gjinore ndaj grave përbën “shkelje të rëndë të të drejtave të grave dhe vajzave dhe pengesë kryesore për arritjen e barazisë midis burrave dhe grave”⁷, strategjia në brendësin e saj përfshinë perspektivën gjinore duke përcaktuar masa konkrete në kuadër të planit të veprimit për fuqizimin e gruas dhe arritjen e barazisë midis burrave dhe grave.

Të bindur se investimi në kapital njerëzor nuk është vetëm gjëja e duhur për të bërë nga pikëpamja etike dhe morale, por është gjithashtu gjëja më e mençur të bëhet nga pikëpamja ekonomike për njerëzit, familjet e tyre, komunitetin, shoqërinë dhe shtetin në përgjithësi. Në këtë kuptim, strategjia adreson edhe parimet dhe dimensionet e traktateve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, veçanërisht të Konventës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, si:

⁶ Marrëveshje Mirëkuptimi për Institucionalizimin e Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje dhe Mënyrën e Funkcionimit të të tij , në Komunën e Hanit të Elezit më datë 06.12.2018

⁷Këshilli i Europës, Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, preambula, 2011;

dinjiteti njerëzor⁸;

#barazia në mes grave dhe burrave⁹;

mos-diskriminimi¹⁰;

moskthimi¹¹;

duke kërkuar që jetesa në komunitet të zhvillohet bazuar në respektimin eshtetit të së drejtës, të drejtave të njeriut, të drejtave të barabarta për burra dhe gra dhe respektimin e demokracisë.

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje për Komunën e Hanit të Elezit, mundëson edhe koordinimin e përpjekjeve ekzistuese të të gjitha departamenteve dhe institucioneve qeverisëse komunale dhe të organizatave joqeveritare, duke angazhuar struktura të ndryshme publike dhe private, për të diskutuar dhe zgjidhur çështjet të ndryshme si ato të arsimit, shëndetit, shërbimeve sociale, punësimit, drejtësisë, familjes, fëmijëve dhe të moshuarve, etj.

Me zbatimin efikas të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Komuna Hanit të Elezit do të fuqizojë dhe rrisë efikasitetin e mekanizmave institucional për mbrojtje, parandalim, ndjekje penale dhe eliminim të dhunës në familje, vetëdijesimin e shoqërisë për të sfiduar sjelljet e dhunshme duke besuar dhe mbrojtur qëndrimin se dhuna në familje kundërshtojë cilindo anëtarë të saj është e pa-tolerueshme.

Dokumenti strategjik i referohet zbatimit të kuadrit ligjor kundër dhunës në familje në tërësi, i cili ndër të tjera thekson:

1. Të hartohen politika në nivel lokal për parandalimin, mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat dhe ushtruesit e dhunës në familje.
2. Mbështetja financiare e strehimoreve regjionale që mbështesin nëna me fëmijë, në proporcion me numrin e rasteve nga Komuna e Hanit të Elezit të strehuara si viktima të dhunës në familje.

Përmbushja e obligimeve që rrjedhin nga strategjia do të kontribuojnë edhe në arritjen e synimeve nacionale të përcaktuara sipas Qëllimeve për Zhvillim të Qëndrueshëm në Kosovë (SDG), që bëjnë thirrje për eliminimin e pabarazive (SDG5)¹², objektiv kjo që synon eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe vajzave, përfshirë trafikimin dhe format e tjera të shfrytëzimit si dhe eliminimin e të gjitha praktikave të dëmshme siç janë martesat e fëmijëve, martesat e hershme dhe të detyruara; si dhe promovimin e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm (SDG 16)¹³ objektiv kjo që synon përfundimin e

⁸ OKB, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, preambula 1948;

⁹ Këshilli i Europës, Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, preambula, neni 4.2, 2011;

¹⁰ Po aty, neni 4.3;

¹¹ Po aty, nenet 59-61, “kërkon që gratë viktima të dhunës në familje, pavarësisht nga statusi ose vendbanimi i tyre, nuk do të kthehen në asnjë vend ku jeta e tyre do të ishte në rrezik ose ku ato mund t'i nënshtrohen torturës, apo trajtimit çnjerëzor ose degradues”.

¹² Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave;

¹³ Paqe, drejtës dhe institucione të forta;

abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe të gjitha formave të dhunës ndaj dhe torturës ndaj fëmijëve dhe zvogëlimin e të gjitha formave të dhunës dhe vdekjeve të lidhura për të arritur një shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse.

Përmbushja e këtyre obligimeve dhe synimeve strategjike, do të mundësoj që Komuna Hanit të Elezit të shndërrohet në vend ku dhuna ndaj grave dhe në familje nuk tolerohet, reformimi i sistemit të mbrojtjes sociale të udhëheqet nga parimi i barazisë, si dhe të ndikohet në instalimin e filozofisë së inkurajimit të politikave sociale parandaluese, duke nxitur përparimin shoqërorë dhe qytetarisë demokratike në arritjen e vetëdijes më të lartë kolektive për barazi gjinore dhe të të drejtat e gruas të garantuar me konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, veçanërisht për Konventën e Këshillit të Europës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës Kundër Grave dhe Dhunës në Familje.

II. Hyrje

Ndonëse, dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje është shkelje e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut¹⁴ dhe përbën goditje të dinjitetit njerëzor, si në gjithë globin edhe në shoqërinë kosovare ajo vazhdon të jetë e përhapur me përmasa mjaftë të mëdha.

Dhuna ndaj grave është manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis burrave dhe grave¹⁵ dhe me të drejtë konsiderohet pengesa më madhe në realizimin e një bote paqësore, të prosperuar dhe të qëndrueshme. Krahës vështirësive ekonomike, shoqëria jonë po ballafaqohet edhe me një sërë problemesh tjera si: papunësia, lëvizjet demografike, ndryshime të koncepteve mbi vlerat dhe virtytet njerëzore, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e ulët të gruas në vendimmarrje dhe pabarazisë gjinore.

Duke qene se dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje gjithnjë e më shumë po njihet jo vetëm si shkelje e të drejtave individuale, por edhe si kërcënim për demokracinë, pengesë për zhvillim shoqëror dhe rrezik për paqe të qëndrueshme, pasojat e së cilës tronditin jo vetëm rrethim e ngushtë të familjes por të gjithë shoqërinë, dhe si e tillë kërkon angazhim të gjithë shoqërisë për marrjen e masave të nevojshme për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje, misioni i OSCE në Kosovë mori iniciativën të përkrahë Mekanizmin Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në hartimin e Strategjisë Komunale dhe Planin e Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2024- 2026).

Parasëgjithash, Strategjia do të ndikoj në rritjen e bashkëpunimit në mes të qytetarit dhe institucioneve shtetërore, shtyllat e së cilës janë të vendosura në “parandalimin e dhunës, mbrojtjen e viktimave të saj dhe ndjekja penale e dhunuesve”. Ajo synon gjithashtu të ndryshojë

¹⁴Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, 1994;
<https://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/ViolenceAgainstWomen.aspx>, qasur më 1 korrik 2021;

¹⁵Këshilli i Europës, Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, preambula, 2011;

mendësitë e individëve duke iu bërë thirrje pjesëtarëve të shoqërisë, në veçanti burrave dhe djemve, të ndryshojnë sjellje.

Po ashtu, me anë të dokumentit strategjik synohet të vendoset një kornizë gjithëpërfshirëse dhe e unifikuar e përpjekjeve institucionale në kuadër të reformimit të sistemit për mbrojtjen nga dhuna në familje. Masa këto që i referohen fuqizimit të mekanizmave koordinues për reagim dhe bashkëpunim të shpejtë për parandalim dhe mbrojtje efikase të rasteve të dhunës në familje; promovimin e programeve dhe aktiviteteve për fuqizimin e grave, çrrënjosjen e paragjykimeve e stereotipeve si dhe pasojat e tyre; sigurimi i qëndrueshmërisë së shërbimeve për rehabilitim dhe riintegrim të viktimave të dhunës në familje.

Dokumenti strategjik identifikon çështjet që me prioritet kanë nevojë për ndërhyrje të menjëhershme duke kërkuar bërjen e përpjekjeve maksimale që të sigurohet “Një shoqëri që iu siguron të gjithë shtetaseve të saj, të rritur dhe fëmijë, të jetojnë pa frikë apo kërcënimin e dhunës në familje, që mbron viktimat, vendos kryerësit përpara përgjegjësisë dhe zvogëlon tolerancën e publikut ndaj veprimeve të dhunshme në familje”.¹⁶

Realizimi i të drejtave të njeriut, fillon me sigurimin e barazisë, rezultatet e të cilit janë të ndërlidhura në nivel të lartë të produktivitetit për ekonomin, gjendjen sociale dhe zhvillimin e vendit. Strategjia parashihet të jetë katalizatorë që duke përcaktuar hapat e mëtejshme që duhet ndërmerren drejt një strukture koherente për promovim, respektim, mbrojtje dhe luftim të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, të ndikojnë në përsheptimin e investimeve më të mira dhe të shtuara për të drejtat e njeriut për një barazi më të madhe dhe rritje ekonomike në vend. Për më tej, Strategjia në vete bënë edhe thirrje për aksion, që të bashkojmë dijet, energjinë, mundësit dhe financat, për realizim të plotë të të drejtave të njeriut, për të rritur mirëqenien dhe eliminimin e kohezionit social në Komunën e Hanit të Elezit.

III. Metodologjia

Strategjia për Mbrojtje nga Dhuna në Familje është hartuar duke u bazuar në një metodologji të kombinuar në mënyrë që të jetë gjithëpërfshirëse, të adresojë prioritetet kyçe bazuar në nevojën për ndërhyrje dhe të siguroj që aktivitetet e përcaktuara do të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike.

Në aspektin strukturor dhe përmbajtësor “Strategjia për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2021-2025) është hartuar në përputhje të plotë me Udhëzimin Administrativ (QRK) nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, Rregulloren e Punës së Qeverisë Nr.09/2011 dhe Rregulloren (QRK) Nr.05/2016 për Standardet minimale për procesin e Konsultimit Publik.

¹⁶Ministria e Drejtësisë, Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit (2016-2020), 2016;

Hartimi i strategjisë është kryer përmes një procesi të gjatë pjesëmarrës, nën drejtimin e Komunës, drejtuesit më të lartë dhe stafet përgjegjëse të drejtorive të ndryshme përfshirë në proces, së bashku me të gjitha institucionet e tjera në nivel komunal. Janë organizuar një sërë takimesh të gjera për njohjen e situatës, hartimin e drejtimeve strategjike dhe planifikimin e aktiviteteve specifike sipas termave kohorë të kësaj strategjie.

Përgjatë procesit të hartimit të dokumentit strategjik janë organizuar punëtori me akterët relevantë në kuadër të Mekanizmit Komunal Koordinues Kundër Dhunës në Familje. Pjesëmarrës në punëtori ishin përfaqësues të: Policisë së Kosovës, Prokurorisë Themelore Ferizaj, Gjykatës Themelore dega në Kaçanik, Zyrës për Mbrojtje të Viktimave, Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, Drejtorisë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtorisë Komunale për Arsim, Drejtorisë së Financave, Drejtorisë për zhvillim Ekonomik, Qendrës për Punë Sociale, Zyrës për Barazi Gjinore, Qendra e Mjekësisë Familjare, Strehimore dhe sipas nevojës janë realizuar takime individuale me aktorët kyç institucional dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Veprime këto që kanë shërbyer të pranohen pikëpamjet dhe kontributet e të gjithë përfaqësuesve në kuadër të Mekanizmave Koordinues Kundër Dhunës në Familje dhe akterët tjerë relevantë, duke i vënë në pah përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet eventuale, në përmbushjen e objektivave të dokumentit strategjik. Po ashtu, punëtorja ka shërbyer si mjet për të pranuar pajtueshmërinë e të gjithëve në përcaktimin e qëllimit, objektivave, aktiviteteve, rezultateve dhe treguesve të dokumentit Strategjik.

Përgjithësisht, procesi i hartimit të strategjisë ishte i ndarë në tri faza:

Faza e parë është karakterizuar me analizimin e situatës së përgjithshme, me ç'rast janë konsideruar dhe analizuar instrumentet dhe standardet ndërkombëtare, korniza ligjore vendore në fuqi, politikat dhe strategjitë për mbrojtje nga dhuna në familje, si dhe raporte, hulumtime e vlerësime të ndryshme, vendore e ndërkombëtare, të kryera së fundmi lidhur me fenomenin e dhunës në familje.

Faza e dytë është karakterizuar me realizimin e punëtorive dhe sesioneve individuale me aktorët kyç institucional dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Ndërsa, në fazën e tretë dokumenti i është nënshtruar procesit të konsultimeve publike, duke u siguruar që procesi i hartimit të dokumentit strategjik është bërë i njohur dhe iu është dhënë mundësia për ofrimin e komenteve të gjithë akterëve institucional në nivel qendror dhe lokal, përfaqësuesve të OJQ, duke u siguruar që procesi i hartimit të dokumentit strategjik është bërë i njohur dhe iu është dhënë mundësia për ofrimin e komenteve të gjitha palëve të interesit, duke synuar pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në procesin e parandalimit dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje në përputhje me interesin më të mirë të tyre.

Udhëheqësi i mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje në bashkëpunim të ngushtë me anëtarët e mekanizmit nën përkrahjen e Misionit të OSCE në Kosovë, ka shqyrtuar, inkorporuar dhe validuar inputet e pranuar nga procesi i konsultimit publik dhe sipas legjislacionit në fuqi, dokumenti strategjik është proceduar për aprovim në Kuvendin Komunal.

IV. Sfondi

4.1 Analiza e përgjithshme e situatës së dhunës në familje

Barazia gjinore është një parim i të drejtave të njeriut, andaj të drejtat e grave janë pjesë e patjetërsueshme, integrale dhe e pandashme e të drejtave universale të njeriut. Një jetë e lirë nga dhuna është një parakusht dhe një kërkesë themelore për një jetë të barabartë. Kur flasim për “mbrojtjen nga dhunën në familje”, Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me institucionet qeveritare në nivel qendror dhe lokal, veçanërisht Agjencinë për Barazi Gjinore, me përkrahjen e organizatave vendore e ndërkombëtare, si misioni i OSBE në Kosovë, ka arritë të zhvillojë nisma reformuese dhe avancime pozitive në kontekst të zbatimit praktik të kuadrit ligjorë duke adresuar standardet ndërkombëtare¹⁷.

Reforma këto që kanë ndikuar në zhvillimin e vullnetit politik dhe angazhimit institucional në përfshirjen e “barazisë gjinore” në qendër të politikave strategjike që ka rezultuar me hartimin e politikave dhe legjislacionit vendorë në përputhje me standardet ndërkombëtare, hartimin e programeve specifike për mbrojtje nga dhuna në familje dhe për barazi gjinore, marrjen e masave që synojnë të përmbushin nevojat specifike të grave dhe zhdukjen e zakoneve/praktikave që rezultojnë negativisht në gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut.

Mirëpo, përfshirja e këtyre standardeve në agjendën e politikave institucionale nënkupton jo vetëm zotim për realizim të tyre, por marrjen e një sërë masash për përmbushjen e një numri të caktuar të kërkesave që duhet të shihen si tregues cilësorë të vullnetit politik për të arritur në thelb barazinë gjinore, për rrjedhojë edhe mbrojtjen nga dhuna në familje.

Bazuar në të gjeturat raporteve të monitorimit për mbrojtjen nga dhuna në familje, që njëherit pasqyrojnë situatën aktuale sa i përket barazisë gjinore në Republikën Kosovë duke ofruar informata mbi treguesit kyç të cilët janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në legjislacionit vendor, Konventën e Këshillit të Europë për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje dhe Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (të njohur si SDG), rezultojë se janë bërë përmirësime të ndjeshme duke evidentuar arritjet më të rëndësishme, përfshirë: zvogëlimin e qëndrimeve paragjyquese dhe sjelljeve që e mbështesin dhunën në

¹⁷ Standardet e përcaktuara në “Rekomandim i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës CM/Rec (2007)/17 Rekomandim për standardet dhe mekanizmat e barazisë gjinore”;

familje; themelimin e mekanizmave koordinues në nivel qendror dhe lokal kundër dhunës në familje; rritjen e njohurive në mesin e profesionistëve që direkt ose indirekt punojnë për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje; lehtësimi i qasjes në shërbime dhe rritja e efikasitetit të tyre, për reabilitim dhe riintegrim të viktimave të dhunës në familje. Të arritura këto, të cilat janë në hap me agjendën dhe përpjekjet globale për mbrojtjen nga dhuna në familje.

Megjithatë, mbetet ende shumë për t'u bërë për të përmirësuar përpjekjet e bashkërenduara institucionale në fuqizimin e mekanizmave për reagim të shpejtë, mbrojtje dhe trajtim të rasteve të dhunës në familje; për të siguruar mirëqenien e viktimave të dhunës në familje; rehabilituar dhe riintegruar viktimave të dhunës në familje duke ju siguruar mundësi të jetojnë të barabartë dhe me dinjitet; nxitjen e përparimit shoqëror duke mos e toleruar dhe justifikuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje; dhe vënien përpara përgjegjësisë, njëkohësisht reabilitimin e vazhdueshëm të kryesve të dhunës në familje.

Dhuna me bazë gjinore është shkelja më e rëndë nga shkeljet me të cilat përballen shumë gra dhe vajza. Pabarazia gjinore dhe dhuna ndaj grave janë ngushtë të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Parandalimi i dhunës me bazë gjinore shpesh mbizotëron diskursin për pabarazinë gjinore, posaçërisht në shoqëritë më patriarkale, siç është Kosova. Vlerësohet se të paktën 12 gra vriten nga dhuna e lidhur me gjininë në Evropë çdo ditë. Ndërsa, në Kosovë një në çdo tre gra ka përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri¹⁸.

Mbizotërimi i dhunës me bazë gjinore mbetet alarmant në Kosovë. Gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar, ka pasur një rritje në numrin e raportuar të rasteve të vrasjeve që kanë rezultuar nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore. Derisa mesatarja vjetore e rasteve të raportuara ndërmjet viteve 2002 dhe 2017 ishte 1.152, vetëm në vitin 2019 u raportuan 1.915. Përkundër rritjes së numrit të rasteve të raportuara të dhunës në familje, bazuar në përfundimet e sondazheve konkludohet se incidentet aktuale janë shumë më të larta, deri në 68% dhe se shumë raste mbeten të pa raportuara. Gjatë viti 2020 dhe veçanërisht gjatë kohës së masave të bllokadës për shkak të parandalimit të përhapjes së virusit COVID-19, sipas të dhënave të Policisë së Kosovës gjatë vitit 2020 janë raportuar, pothuajse, 650 raste të dhunës në familje në të gjithë vendin: 161 raste të raportuara në muajin janar, 151 në muajin shkurt, 169 në muajin mars dhe 167 në muajin prill.¹⁹

Ndërsa, reagimi i institucional për marrjen e masave të nevojshme dhe efektive për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe me bazë gjinore, rezultonë të jetë i dobët. Këtë e dëshmon edhe norma lartë e rasteve të hedhura poshtë të dhunës në familje, pasi gjatë vitit 2017 ishin më shumë se gjysma e të gjitha kallëzimeve penale të lidhura me rastet e dhunës në familje (51.5%) që ishin hedhur poshtë nga gjykatat e Kosovës. Për më tepër, gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2018, u

¹⁸UN Women, "Fakte dhe Shifra: Përfundimi i dhunës kundër grave një pandemi në formate ndryshme", faqja e qasur më 22.7.2018. at: www.unwomen.org/en/ëhat-ëe-do/ending-violence-against-ëomen/facts-and-figures;

¹⁹<https://balkaninsight.com/> COVID-19 dhe dhuna në familje: Kur shtëpia s'është vendi më i sigurt, prill, 2020;

hordhën poshtë gjithsej 15.1% raste. Për periudhën e monitoruar për 2015-2018, vetëm 40.4% e rasteve kanë marrë vendime të fajësisë. Kjo përgjigje e ngadaltë nga sistemi i drejtësisë penale ndaj rasteve të dhunës në familje ka çuar në shfaqjen e përgjithshme të mosndëshkimit për autorët e dhunës në familje. Për më tepër, viktimat që fajësohet dhe pajtimi i viktimës me kryerësin mbetet e zakonshme në mesin e të gjitha institucioneve të monitoruara, shpesh të justifikuara me qëllim të "shpëtimit" të familjes tradicionale²⁰. Për më tej, studimet vinë në përfundim se: gati një e treta e kosovarëve besojnë se në familje "dhuna është pjesë normale e çdo marrëdhënieje dhe shoqëria në përgjithësi pranon se dhuna mund të ndodhë ndonjëherë". Për më keq, një në tre kosovarë beson se dhuna në familje është "problem familjar, kështu që fqinjët nuk duhet ta raportojnë atë në polici"²¹.

4.2 Analiza e situatës së dhunës në familje në Komunën e Hanit të Elezit.

Dhuna në Familje nuk është një dukuri e re për qytetarët e komunës sonë, por edhe shoqërinë kosovare në përgjithësi. E shprehur në formë dhe intensitete të ndryshme ajo është trashëguar prej së shkuarës, por në ditët e sotme vërehen edhe shumë tipare të reja të shprehjes së saj. Analiza e shkurtër e situatës në Komunën e Hanit të Elezit ka ndihmuar të qartësohet lista e problemeve dhe shkaqeve që i shkaktojnë ato. Shkaqet që çojnë në rritjen e shkallës së Dhunës në Familje janë të shumta, ndërmjet të cilave përmendim:

Pabarazitë gjinore: Në Kosovë, roli i femrave në proceset e zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe politik është shumë i rëndësishëm, ndonëse ende në ditët e sotme ndeshemi me pabarazi gjinore të dukshme apo të fshehura. Pozita e pabarabartë gjinore ndikohet nga shkalla e ulët e punësimit të grave, vështirësitë që kanë në qasje të shërbimeve shëndetësore, niveli i ulët i integritetit të grave në ekonomi dhe numri i vogël i grave në pozitat udhëheqëse në administratën publike.

Në Kosovë është krijuar një bazë e mirë ligjore sa i përket çështjes së barazisë gjinore dhe janë bërë hapa të dukshëm në avancimin e pozitës së grave, ku Komuna e Hanit të Elezit krahas viteve të mëhershme, ka shënuar progres të dukshëm në avancimin e gruas. Të dhënat paraqesin një përfshirje më të madhe të grave në politikë, në arsim, e sektorë të tjerë. Megjithatë, ende nuk është arritur përfaqësimi i kënaqshëm gjinor, i paraparë në Ligjin për Barazi Gjinore, në të cilin përcaktohet se pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve, në institucione apo në nivel të pushtetit.

Duke pasur parasysh trendet e shkallës së papunësisë, për një pjesë të popullsisë në Komunën e Hanit të Elezit, femra mbetet në pozitë më të pafavorshme krahasuar me meshkujt si në lëmin e punësimit, nivelit të varfërisë, arsimin, si dhe pjesëmarrjen aktive në sferën publike dhe private.

²⁰KIPRED, Qasja në drejtësi e viktimave të dhunës me bazë gjinore në Kosovë: Përfundimi i mosndëshkimit të autorëve të krimit, 2018;

²¹Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovë, Mjaft më me arsytimit: Analiza e qëndrimeve, incidencës dhe reagimeve institucionale ndaj dhunës në familje në Kosovë, 2015;

Raste të dhunës në familje për 3 vite në komunën tonë pra raste të cilat janë lajmëruar sepse shifrat janë edhe më të mëdha

2020: 3 raste të dhunës në familje

2021: 3 raste të dhunës në familje

2022: 4 raste të dhunës në familje

4.3. Pasojat më të theksuara të dhunës në familje

Dhuna në Familje sjell shumë pasoja në komunitet, të cilat kanë një numër të madh efektesh të padëshiruara:

Kriza familjare: Avancimi i rolit të femrës në shoqëri dhe pozita e saj në familje ka ndryshuar në kuptimin e pavarësisë më të madh të saj, marrjes së iniciativave, edukimit dhe arsimimit, fakte të cilat kanë ndikuar në ndryshimin e roleve në familje dhe shoqëri. Kriza familjare në periudhën e pas luftës në Kosovë ka shkaqe të ndryshme: lëvizja e popullatës nga fshatrat në qytete, kalimi nga familjet e zgjeruara dhe të mëdha në familje më të vogla. Të tilla ndryshime shihen si faktorë mbrojtës (kur shmanget ndikimi patriarkal prej brezave më të vjetër), por edhe faktorë rreziku njëherësh, si pamundësia e mbrojtjes në rastet e dhunës në familje të nxitura nga papunësia, konfliktet dhe mentalitetit mes gjeneratave, etj.

Frika dhe ndërjegjësimi ulët për çështjet e dhunës në familje: Mos raportimi i dhunës në familje nga viktimat është ndër fenomenet më të shpeshta, pasi konsiderohet turp dhe një çështje që nuk duhet të dalë jashtë mureve të shtëpisë.

Mospranimi i dhunës seksuale: Për shkak të stigmës dhe ndëshkimit vërehet mos raportim i dhunës nga ana e viktimave dhe për këtë dhuna seksuale rezulton më pak e raportuar ose nuk ekziston fare në krahasim me dhunën fizike.

Probleme lidhur me trashëgiminë: Sa i përket procedurave të shqyrtimit të trashëgimisë, shumë herë ndodh që gruaja nuk njoftohet fare ose përjashtohet nga diskutimi për masën trashëgimore, qoftë në pozitën e bashkëshortes, nënës apo motrës dhe në këtë mënyrë diskriminohet. Veç kësaj, organi kompetent komunal për mbajtjen e librit amzë të vdekjeve ka për detyrë që në aktvdekje të shënojë emrat e trashëgimtarëve femra dhe meshkuj dhe asesi të mos i diskriminojë femrat

V. Objektivat strategjike

“Dhuna ndaj grave në thelb është çështje e pushtetit. Ajo do të përfundojë vetëm kur barazia gjinore dhe fuqizimi i plotë i grave do të behën realitet.” (Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, António Guterres)

Objektivat strategjike kanë pikë synim të kontribuojnë në arritjen e barazisë duke punuar në parandalimin e dhunës në familje, sepse një jetë e lirë nga dhuna është një parakusht dhe një kërkesë themelore për një jetë të barabartë.

Po ashtu, të rrisin ndikimin dhe dukshmërinë e standardeve ndërkombëtare dhe zbatimin e kornizës ligjore kombëtare për mbrojtjen nga dhuna dhe promovimin e barazisë gjinore, duke mbështetur zbatimin e tyre përmes një sërë masash që promovojnë ndryshimin në modelet shoqërore dhe kulturore të sjelljes së gra dhe burra.

Të sigurojë që vajzat trajtohen me respekt të plotë për dinjitetin dhe të drejtat e tyre duke promovuar mjedis pa dhunë në Komunën e Hanit të Elezit . Për të siguruar që profesionistët që ofrojnë shërbime themelore për mbrojtje të viktimave të dhunës në familje, kanë njohuritë e nevojshme për të integruar një perspektivë gjinore në politikat publike, si dhe marrjen e masave të nevojshme për parandalimin e dhunës në familje.

Strategjia komunale kundër Dhunës në Familje për Komunën e Hanit të Elezit synon të:

- ☐ Të punojë në parandalimin e dhunës në familje dhe ngritjen e vetëdijes tek komuniteti për aspektet negative të këtij fenomeni;
- ☐ Të përmirësojë/ndërtojë sistemin e grumbullimit dhe shkëmbimit të të dhënave në mes të akterëve relevant;
- ☐ Të fuqizojë mekanizmat për reagim sa më të shpejtë ndaj rasteve të dhunës në familje dhe të përmirësojë koordinimin në mes anëtarëve të grupit gjatë menaxhimit të tyre;
- ☐ Të bëjë avokim dhe monitorim të zbatimit të politikave si dhe të sugjerojë ndryshime bazuar në përvojat më të mira nga terreni.

Mbështetur në tri fusha të veprimit, si **“Vetëdijësimi dhe Parandalimi”**; **“Mbrojtja dhe Koordinimi”**; **“Fuqizimi ekonomik, rehabilitimi dhe riintegrimi”** me anë të adresimit të objektivave strategjike dhe specifike, si:

Objektiva Strategjike #1: Përmirësimi i sistemit institucional për parandalim dhe ofrim të shërbimeve cilësore për mbrojtje nga dhuna në familje:

Objektiva specifike #1.1: Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;

Objektiva specifike #1.2: Vetëdijësimi i opinionit publik për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;

Objektiva specifike #1.3: Inkurajimi i qytetarëve dhe viktimave të dhunës në familje për raportimin e rasteve të dhunës në familje;

Objektiva Strategjike # 2: Përmirësimi i qeverisjes lokale për parandalimin dhe mbrojtje nga dhuna në familje:

Objektiva specifike # 2.1: Funksionalizimi i Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje;

Objektiva specifike # 2.2: Fuqizimi i sistemit të raportimit dhe ankesave për mbrojtje nga dhuna në familje;

Objektiva specifike # 2.3: Avancimi i monitorimi të politikave dhe obligimeve ligjore për mbrojtje nga dhuna në familje;

Objektiva specifike # 2.4: Fuqizimi ekonomik i grave dhe viktimave të dhunës në Familje;

Objektiva Strategjike # 3: Fuqizimi i shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese të viktimave të dhunës në familje:

Objektiva specifike # 3.1: Avancimi i shërbimeve rehabilituese për mbrojtje nga dhuna në familje;

Objektiva specifike #3.1: Avancimi i shërbimeve riintegruese për mbrojtje nga dhuna në Familje;

VI.Plani i Veprimit

FUSHA E VEPRIMIT – A. ELIMINIMI I PABARAZIVE GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE Deri në vitin 2026, strategjia lokale synon të ndryshojëqasjen në familje dhe shoqëri për eliminimin e pabarazisë gjinore dhe dhunën në familje					
Drejtimi strategjik	Aktivitete	K Koha e zbatimit Sipas shtyllave: <u>Parandalim</u>, <u>Mbrojtje</u>, <u>Riintegrim</u> Sipas kohës së zbatimit: ASH – Afatshkurtër, AM – AfatMesëm; AGJ –Afat Gjatë	Indikatori i suksesit	Institucion përgjegjës për zbatim	Kostoja buxhetore
A.1. Eleminimi i stereotipeve gjinore për luftimin e dhunës në familje	1.1 Fushata vetëdijësuese dhe kampanja informuese, vebfaqja komunës, rrrjetet sociale, për publikun e gjerë në komunën e Hanit të Elezit	P+M+R ASH+AM	Prej rreth 10.000 banorëve , rreth 50% e tyre ta marrin mesazhin si dhe të jen bërë pjesë e aktiviteteve ndërgjegjësuese	QPS PK ZBGJ Komuna DKA OJQ-te QKMF KBI Zyra per ndihm juridike falas	300 €
	1.2 Trajnimet për Barazi gjinore dhe dhunën në familje me përfaqësues të instucioneve vendore	P+M+R ASH+AM			200 €
A.2. Ngritja e vetëdijësimit të grave dhe të rinjve, institucioneve dhe bizneseve për pasojat e dhunës në familje dhe të pabarazisë gjinore.	2.1 Fushata (drama, me temë të barazisë gjinore dhe dhunës në familje, ligjërata, ese, dhe piktura) me të rinjtë;	P Aktivitet në vijimësi	Rritja e përqindjes së grave dhe vajzave të ndërgjegjësuar nga 20% në 40%	Komuna ZBGJ DKA Policia OJQ Donatorë QKMF KBI	300 €
	2.2 Takime me gra dhe vajza në fshatra për të drejtat e tyre ligjore, me fokus në DHF, dhe lajmërimi i rasteve të DHF, gjatë takimeve do të shpërndahen informacione dhe fletëpalosje	P Aktivitet në vijimësi			200 €

A.3 Hulumtimi dhe mbledhja e të dhënave dhe statistikave të dhunës në familje, në Komunën tonë.			Mbshteja instucionale e mekanizmit Hulumtimi , ruajtja e te dhenave,	Komuna MKDHF OJQ QKMF Donatorë	300 €
	Takimete e rregullta të mekanizmit kundër dhunës në familje dhe diskutimi i rasteve Krijimi i një databaze ndërinstucional – mekanizmi	P+M+R AGJ AGJ			
A.4. Fuqizimi i rolit te gruas në shoqëri përmes promovimit dhe rritjes së numrit të femrave në pozicionet vendimmarrëse	3.1 Ndarja e përvojave tësuksesshme të modeleve në takime me gratë dhe komunitetin	P AGJ	Rritja e përqindjes së grave pjesëmarrëse aktive në takime Rritja e përqindjes së grave në pozicionet vendimmarrëse nga 30% në 45%	Komuna ZBGH OJQ lokale Grupi i grave asambleiste	200 €

FUSHA E VEPRIMIT – B. ARSIMIMI DHE INFORMIMI

Deri në vitin 2026, strategjia lokale synon një komunitet të mirë informuar , edukuar në çështjet e dhunës në familje , me profesionistë të përgatitur për të parandaluar, njohur dhe kualifikuar për trajtimin adekuat të viktimave të dhunës në familje dhe të komunitetit në tërësi si dhe të kryerësve të veprave penale

Drejtimi strategjik	Aktivitete	Lidhja me Strategjinë Kombëtare dhe Koha e zbatimit Sipas shtyllave: <u>Parandalim</u> , <u>Mbrojtje</u> , <u>Riintegrim</u> Sipas kohës së zbatimit: ASH – Afatshkurtër, AM – AfatMesëm; AGJ –Afat Gjatë	Indikatori I suksesit	Institucioni përgjegjës për zbatim	Kostoja buxhetore
B.1 Ndërgjegjësimi i nxënësve dhe prindërve të AMU dhe AML për çështjet e dhunës në familje	1.1 Aktivitete informuese nëpërmjet mekanizmit kordinues, në kuadër të orëve mësimore dhe të fletëpalosjeve, broshurave, etj	P+M+R Aktivitet në vijimësi	Deri në vitin 2026, rreth 50% e nxënësve dhe prindërve janë të ndërgjegjësuar për LMDF dhe DHF	Mekanizmi kordinues QPS ZBGJ Drejtoria e arsimit, QKMF, OJQ – të PK KBI	300 €
	1.2 Informimi i qytetarëve përmes ueb faqes se komunes, rrjeteve sociale	P Aktivitet në vijimësi			
	1.3 Aktivitete informuese dhe edukuese në kuadër të programit të aktiviteteve shkollore me pjesëmarrjen e nxënësve (orë mësimore, fushata, postera)	P ASH + AM			

B.2 Ngritja profesionale e mësimeve të edukatës qytetare lidhur me DHF dhe trajtimin e saj	2.1 mbajtja e ligjëratave në orën mësimore me temën dhuna në familje, dukurit negative në shoqëri nga mësuesit e edukatës qytetare.	P Aktivitet në vijimësi	Deri në vitin 2026, 15% e orëve të edukatës qytetare do të kalojnë në tematika të DHF	Drejtoria e Arsimit ZBGJ Komuna OJQ	150 €
	2.2 Organizimi i vizitave studimore për shkëmbimin e përvojave me vendet e rajonit dhe komunave	P AM			Donatorët
B.3 Ulja e numrit të nxënësve që braktisin shkollën e ulët dhe të lartë si rezultat i DHF, në zonat rurale.	3.1 Kryerja e hulumtimeve sociologjike mbi shkaqet kryesore të braktisjes së shkollës prej nxënësve të familjeve ku ushtrohet dhunë	P+M+R ASH	Deri në vitin 2026, ulet numri i nxënësve që braktisin shkollën prej DHF	Drejtoria e Arsimit Mekanizmi kordinues	
	3.2 Monitorimi i aplikimit të masave ligjore që sanksionojnë braktisjen e shkollës	P+M ASH+AM			

FUSHA E VEPRIMIT – C. FUQIZIMI I BAZËS EKONOMIKE

Deri në vitin 2026, strategjia lokale synon në parandalimin, mbrojtjen dhe rintegrimin përmes mbështetjes ekonomike dhe dhënien e mundësive për mirëqënien e të mbijetuarave të DHF dhe të familjeve të tyre si dhe kryerësve të veprës penale

Drejtimi strategjik	Aktivitete	Lidhja me Strategjinë Kombëtare dhe Koha e zbatimit Sipas shtyllave: <u>Parandalim</u> , <u>Mbrojtje</u> , <u>Riintegrim</u> Sipas kohës së zbatimit: ASH – Afatshkurtër, AM – AfatMesëm; AGJ – Afat Gjatë	Indikatori I suksesit	Institucioni përgjegjës për zbatim	Kostoja buxhetore
C.1 Fuqizimi ekonomik i viktimave të dhunës në familje në përkrahjen për punësim dhe vetëpunësim	1.1 Rregjistrimi, evidentimi dhe orientimi i viktimave të DHF pranë komunës dhe zyrës së punësimit	M+R AM	Brenda 3 viteve sistemi i rregjistrimit dhe orientimit bëhet funksional sipas standardeve kombëtare në përpunim	Komuna QPS ZPK Sipas përcaktimit të standartit kombëtar	
	1.2 Ofrimi i këshillave në prezantimin e dokumentacionit për aplikim të suksesshëm sipas tregut të punës	M+R Aktivitet në vijimësi			
	1.3 Hartimi dhe aproviminormaverregullative, përmes krijimit të politikave, për lirim nga taksat komunale në rastet e hapjes së një biznesi të ri	M+R ASH			

C.2. Mbështetje socio ekonomike të mbijetuarave të DHF si dhe strehimi i tyre	2.1 Ofrimi i trajnimeve për ngritjen profesionale, informacioneve për mundësitë për biznes	M+R Aktivitet në vijimësi	40% e viktimave përfitojnë nga shërbimet në këtë kategori	Komuna ZPK	
	2.2 Ofrimin e mbështetjes ekonomike me fond të veçantë prej komunës	M+R AM			
	2.3 Ndarja e subvencioneve për familjet në zonën rurale	P+M+R AM			
	2.4 Përkrahje e strehimores “Shtëpia ime ” për kryerjen e shërbimeve dhe mbështetjen e të mbijetuarave të DHF	M+R Aktivitet në vijimësi			500 €
C.3. Zgjidhje afatmesme e strehimit për rastet e të mbijetuarave të DHF	3.1 Pagesa e qirasë për vendëstrehimin e viktimave të dhunës në familje	M+R Aktivitet në vijimësi		Komuna Donatorë	
C.4 Ttrajtimi i viktimave të dhunës në familjeMbështetja mjekesore dhe psikologjike e të mbijetuarve të dhunës në familje .	1.Trajtimi me prioritet dhe privatesi të plotë (përpos rasteve emergjente) 2. Furnizimi me protokole dhe udhërrëfyes të trajtimit të dhunës në familjedhe furnizimi me medikamente të cilat mungojne nga lista esenciale falas ,mbështetja psikologjike e tyre			QKMF	100 €

VII. Aranzhimet e zbatimit, monitorimit dhe raportimit

7.1. Shtrirja kohore e strategjisë

Synimi kryesorë i Komunës së Hanit të Elezit, pa dyshim se është zbatimi në tërësi i dokumentit strategjikë, proces ky që do të përcaktohet nga realizimi i aktiviteteve dhe objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit nëpër vite. Procesi i zbatimit të strategjisë, do të jetë një proces i realizimit të synimeve strategjike dhe objektivave të saj.

Procesi i zbatimit të masave dhe politikave të parashikuara në Strategjinë Komunale kundër Dhunës në Familje kanë një shtrirje të kohë gjatësisë prej 5 viteve, që përfshin vitet 2021-2025. Ndërsa, për zbatimin e objektivave strategjike, hartohet Plani i Veprimit 3 vjeçarë në të cilat përcaktohen objektivat specifike, aktivitetet konkrete karshi institucioneve përgjegjëse dhe mbështetëse për zbatimin e tyre, treguesit SMART, gjendja ekzistuese, synimi/targeti, burimet financiare, të cilat duhet përllogaritur duke iu referuar buxhetit të paraparë në kornizën/grandin komunal si dhe afatet kohore për përmbushjen e tyre. Gjithashtu, në përllogaritjen e nevojave financiare duhet të merren në konsideratë edhe projektet me financim nga donatorët, në vijim ose të planifikuara, sipas fushave specifike.

Zyrtari/ja për Barazi Gjinore do të jetë përgjegjëse për koordinimin dhe bashkërendimin e punës përgjatë hartimit të Planit të Veprimit në bashkëpunim me të gjithë aktetë relevante. Obligohen të gjitha institucionet mandatore në nivel lokal, për zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara në Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër Dhunës në Familje. Po ashtu, institucionet përgjegjëse, departamentet komunale përkatëse, duhet të sigurojnë përfshirjen e politikave, aktiviteteve që burojnë nga strategjia në kuadër të planeve vjetore të punës së tyre.

Përderisa, monitorimi dhe vlerësimi i realizimit të objektivave dhe efektshmërisë së aktiviteteve përkatëse, janë pjesë integrale e strategjisë dhe komponentë kryesor e procesit të zbatimit të saj. Monitorimi dhe vlerësimi do të shërbejnë për të ndjekur ecurinë e strategjisë, për të matur në proces shkallën e realizimit të objektivave të saj, për të vlerësuar nevojën dhe përcaktuar drejtimit e rregullimeve, veçanërisht lidhur me aktivitetet. Procesi i monitorimit do të realizohet nga Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në bashkëpunim me institucionet lokale përgjegjëse për zbatim të dokumentit strategjikë dhe me pjesëmarrjen e gjerë të organizatave jo qeveritare, strehimoreve dhe grupeve tjera të interesit.

Andaj, çdo fund vit, Zyrtari/ja për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Mekanizmin Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, do të hartojnë raportin vjetor i cili duhet të përmbajë vlerësimin e aktiviteteve më të suksesshme dhe në përgjithësi përmbushjen e qëllimeve të strategjisë, identifikimin e sfidave dhe vështirësive të hasura gjatë procesit të zbatimit si dhe ofrimin e rekomandimeve konkrete për mënjanimin e pengesave të paraqitura përgjatë procesit të përmbushjes së objektivave specifike dhe atyre strategjike. Për monitorimin e zbatimit të dokumentit strategjikë dhe efektivitetit të saj janë esenciale:

- (i) për të siguruar që po arrihen qëllimet,
- (ii) për të monitoruar kontributet e investuara dhe aktivitetet,
- (iii) për të siguruar nëse implementimi po shkon sipas rrjedhës së përcaktuar,
- (iv) për të paralajmëruar institucionet përgjegjëse për problemet/ngecjet ose problemet potenciale para se situata të bëhet kritike,
- (v) për të sugjeruar veprime korrigjuese ose për të rishikuar strategjinë në bazë të përvojës së fituar.

Duke monitoruar strategjinë dhe indikatorët e performancës, Komuna e Hanit të Elezit do të jetë në gjendje të krijojë një pasqyrë mbi gjendjen, d.m.th. në ç ‘pikë ndodhet strategjia drejt arritjes së qëllimeve të përcaktuara, nxjerrjes së mësimave, marrjes së masave korrigjuese, dhe, nëse është e mundur, proceseve rishqyrtuese të saj

7.2. Mekanizmat zbatues

Të gjitha institucionet qeveritare lokale, obligohen të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin të detyrimeve të përcaktuara në “Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje” nëpër vite, në përputhje me përgjegjësitë dhe mandatin ligjor të tyre.

Institucioni kryesor përgjegjës për zbatim të strategjisë është Komuna e Hanit të Elezit me dikasterët e saj (ZBGJ, QPS, QKMF, DKA), Policia e Kosovës, Prokuroria dhe Gjykatat Kshilli i Bashkësis Islame .

Ndërsa si institucione që mund të i ndihmojnë në parandalimin e dhunës në familje, dhe mbrojtjen e viktimave, janë: Ekipa Vepruese për Siguri në Bashkësi – EVSB, Këshilli i Veprimit Rinor Lokal, OJQ-të.

Zyra për Punësim: Në koordinim me Qendrën për Punë Sociale, regjistron dhe evidenton personat, të cilët lajmërohen në zyrë, ndaj të cilëve është ushtruar dhunë në familje. Këtyre personave në cilësi të punëkërkuesve, ju ofrohet: këshillim profesional, informim mbi mundësitë e punësimit, përgatitje dhe ndërmjetësim në punësim, informim për aftësim dhe riaftësim profesional me qëllim përgatitjen për nevojat e tregut të punës.

Mbrojtësi i viktimave i cili bashkëpunon ngushtë me institucionet e tjera që ofrojnë ndihmë për viktimat e Dhunës në Familje, dhe lloje të tjera të dhunës apo trafikimit me qenieve njerëzore, etj si Policinë, QPS, Prokurorinë, Gjykatën, QKMF, strehimoren, etj. Ndër detyrat e tij është të informojë viktimën për të drejtat ligjore, të parapara sipas ligjeve në fuqi për dhunën në familje, të parapërgatitë viktimën për seancat gjyqësore, e shoqëron gjatë seancave si në Prokurori dhe Gjykatë, etj.

Zyra për Ndihmë Juridike falas: Kjo zyrë është në objektin e QPS-së në katin e parë, e cila gjendet në Han të Elezit dhe ofron ndihmë juridike falas edhe për viktimat e dhunës dhe është e hapur dy ditë në javë.

7.2. Mekanizmat monitorues dhe raportues

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit, do të shtrihet në të gjitha institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për realizimin e objektivave të përcaktuara në Strategji si dhe aktiviteteteve që do të përcaktohen në Plan të Veprimit.

Për ta vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve, apo anasjelltas, Mekanizmi Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje do të raportojnë përparimin në jetësimin e zbatimit të dokumentit strategjikë në baza vjetore.

ZBGJ (të përcaktohetkush sipas specifikave të Komunës) do të ketë rolin udhëheqës për të bashkërenduar punën, mbikëqyrur dhe vlerësuar procesin e zbatimit të Planit të Veprimit, në të njëjtën kohë do të shërbejë si Sekretariat, dhe në baza periodike çdo vit/6 muja do t'i raportojë direkt Kryetarit të Komunës. Me ç 'rast, çdo fund vit Mekanizmi Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje është i obliguar të hartojnë "Raportin e Monitorimit" mbi zbatimin e dokumentit strategjikë, i cili do të jetë treguesi kyç për të pasqyruar qartë progresin apo regresin mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe aktiviteteteve të parapara në Planin e Veprimit. Ndërsa, varësisht nga rekomandimet e dala nga "Raporti i Progresit", institucionet përgjegjëse janë të obliguara ti shqyrtojnë dhe të zbatojnë ato në bazë sa më optimale të mundshme.

Njëkohësisht, institucionet qeveritare në nivel lokal, do të raportojnë në bazë të nevojave dhe kërkesës të drejtuar nga ZBGJ (te përcaktohet kush sipas specifikavete Komunes), në mënyrë që raportet institucionale të jenë të unifikuara dhe gjithëpërfshirëse.

Organizatat jo-qeveritare, inkurajohen që në partneritet me institucionet qeveritare të marrin pjesë në zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e dokumentit strategjikë.

Në çdo nismë të realizuar nga institucionet shtetërore, shoqëria civile dhe OJQ-të do të inkurajohen të paraqesin edhe raportet e tyre vëzhguese mbi zbatueshmërinë e dokumentit strategjikë apo raportet e tyre mbi aktivitetet e realizuara që lidhen me projektet dhe programet për realizimin e të drejtave të fëmijëve.

Koordinator i mekanizmit kundër dhunës në familje

Amir Bushi



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02.nr. 8585 /2023

Duke u bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Kosovës me nr. 03/L-040, neni 13 mbi aktet e Kryetarit të Komunës, Strategjisë Kombëtare për Zhvillim, Udhëzim Administrativ (Qrk) nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit numër 01.7703/2018, neni 67, kryetari i komunës nxjerrë:

**VENDIM PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E STRATEGJISË PËR
ZHVILLIM EKONOMIK PLOTËSIMIN ME ANËTAR TJERË**

1. Formohet, komisioni për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik të komunës Hani i Elezit, me këtë përbërje:

- Sevdi Dernjani - Nenkryetar i komunës,
- Majlinda Kaloshi – Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik, Udheheqese e grupit,
- Kimete Kuka – Drejtoreshë për Shëndetesi dhe Mireqenie Sociale,
- Hisni Luri - Drejtor per Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport,
- Nexhmedin Daci - Drejtor per Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- Lindita Ballazhi – Drejtoreshë per Buxhet dhe Financa,
- Natyra Kalisi – Drejtoreshë për Administratë ,
- Arsim Dernjani - Drejtor i Sherbimeve Publike dhe Emergjencë,
- Abduraman Bushi - Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,
- Durim Dernjani - Menaxher i projekteve,
- Bajrush Laci – Shef i zyrës ligjore dhe përfaqësues juridik,
- AZHR Lindje - Agjencion Rajonal per Zhvillim,
- Teuta Hasallari - Përfaqesuese e KVRL-së,
- Amir Qajani - Konsulent i jashtem.
- Florim Shkreta - Kryesues i Kuvendit Komunal
- Resul Suma - Anetar i Asamblese Komunale
- Sherif Berisha - Anetar i Asamblese Komunale
- Hyrijete Isufi - Anetare e Asamblese Komunale
- Ibadete Kuka - Anetare e Asamblese Komunale
- Zaim Bela - Anetar i Asamblese Komunale
- Nora Xhoni - Anetare e Asamblese Komunale
- Refet Kalisi - Anetar i Asamblese Komunale

2. Komisioni ka për detyrë që të takohen sipas nevojës dhe të hartojnë Strategjinë për Zhvillim Ekonomik të komunës së Hanit të Elezit, e cila do të jetë në përputhje të plotë me strategjinë kombetare për zhvillim dhe dispozitave ligjore fuqi.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryetarit të Komunës dhe me këtë plotësohet vendimi i datës 18.11.2022.

4. Vendimi i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Anëtarëve të komisionit, Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Arkivi i Komunës.

Data: 10.10.2023
Hani i Elezit





Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



Nr. 8499

DATA:	10.09.2023
PËR:	Komitetin për Politik dhe Financa dhe për Kuvendin Komunal
PËRMES:	z. Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës Hani i Elezit
NGA:	Kimete Kuka Hasallari Drejtoreshe e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
TEMA:	Shkresë përcjellëse: Draft Plani i Veprimit për Parandalimin e Dhunës në Familje 2024-2026



Të nderuar:

Me anë të kësaj shkrese gjeni të bashkangjitur Draft Plani i Veprimit për Parandalimin e
Dhunës në Familje 2024-2026.



Republika e Kosovës - Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



Nr. 8496

DATA:	09.10.2023
PËR:	Komitetin për Politik dhe Financa dhe për Kuvendin Komunal
PËRMES:	z. Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës Hani i Elezit
NGA:	Kimete Kuka Hasallari Drejtore e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
TEMA:	Shkresë përcjellëse: Draft Plani i Punës së Ekipës për Mbrotjen e të Drejtave të Fëmijëve e 2024-2026



Të nderuar:

Me anë të kësaj shkrese gjeni të bashkangjitur Dr Draft Plani i Punës së Ekipës për
Mbrotjen e të Drejtave të Fëmijëve 2024-2026



REPUBLIKA E KOSOVËS--REPUBLIC OF KOSOVA
MUNICIPALITY OF ELEZ HAN
KOMUNA HANI I ELEZIT



DREJTORIA PËR URBANIZËM, KADASTER DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

8504
Nr.06/_ 2023

DATE:	09.10.2023
PËR:	KPF dhe Kuvendin Komunal
PËRMES:	z. Mehmet Ballazhi – Kryetar i Komunës Hani i Elezit
NGA:	Nexhmedin Daci– Drejtor për Urbanizëm, Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit.
TEMA:	Propozim vendim

Të nderuar,

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 neni 11, 40, si dhe në pajtim me nenin 20 pika 11 të Ligjit nr. 06/L-024 mbi Ndërtimet pa Leje (i njohur ndryshe si Ligji i Legalizimit të Ndërtimeve pa Leje) përmes kësaj shkrese i drejtohem Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit, që të miratoj këtë:

PROPOZIM- VENDIM

1. Lirohen nga pagesa e taksës administrative për legalizimin e ndertimeve pa leje të kategorisë I-rë dhe kategorisë II-të të cilat janë shtëpi, kategoritë e dalura nga lufta: familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës, veteranët, pjestarët e Ushtrisë Qilirimtare të Kosovës, viktimat civile si dhe familjet e tyre.
2. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të autoritetit mbikqyrës- MAPL, si dhe pas publikimit në ëebfaqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës
- Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtja e Mjedisit
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës

Hani i Elezit
09.10.2023

Kryesuesi i Kuvendit
z.Florim Shkreta



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



Nr. 8498

DATA:	10.09.2023
PËR:	Komitetin për Politik dhe Financa dhe për Kuvendin Komunal
PËRMES:	z. Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës Hani i Elezit
NGA:	Kimete Kuka Hasallari Drejtoreshë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
TEMA:	Shkresë përcjellëse: Draft Plani i Veprimit për Parandalimin e Dhunës në Familje 2024-2026



Të nderuar:

Me anë të kësaj shkrese gjeni të bashkangjitur Draft Plani i Veprimit për Parandalimin e
Dhunës në Familje 2024-2026.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA - MUNICIPALITY

HANI I ELEZIT



Nr. 04 / 8577/2023

DATA:	10.10.2023
PËR:	KPF dhe Kuvend Komunal
PËRMES:	Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit
NGA:	Lindita Ballazhi Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
LËNDA:	Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit për vitin 2022



Të nderuar/a,

Bazuar në nenin 14, paragrafi 5 të Rregullores së punës për zbatimin e auditimit me nr.748 të datës 19.05.2023, Komuna e Hanit të Elezit ka përgatitur Raportin periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit për vitin 2022.

Po ju dërgojmë:

- Raportin periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit për vitin 2022

Me respekt,

**Raportin periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të
auditimit për vitin 2022**

Nr.	Komponenta e auditimit	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin e rekomandimit	Statusi i rekomandimit (i zbatuar, pjesërisht i zbatuar ose i pazbatuar)	Sfidat e hasura në zbatimin e rekomandimit
1	Çështja A1 – Tejkallime në furnizim nga sasi të dhe komunalitë	Me kontratën publike nr.659-22-2575-1-2-1 për furnizim me material administrativ dhe shtypi jashtë listës së AQP-së për nevoja të institucioneve të komunës, shkollave, QKMF, çerdhes, përveç kushteve tjera, përmes specifikacionit të furnizimeve janë përcaktuar sasi të kontraktuara për secilin pozicion. Te pagesa për furnizim me material administrativ në vlerë prej 5,264.00 €, kemi identifikuar që për 16 pozicione/produkte kishte tejkallim të sasive të furnizimit në krahasim me sasi të kontraktuara. Tejkallimet e sasive për pozicione të ndryshme ishin nga 6 njësi deri në 5,006 njësi. Ndërsa vlera financiare e tejkallimit në total është 1,608.00€. Kjo ka ndodhur për shkak se në procesin e planifikimit të nevojave, njësia kërkuese nuk ka analizuar apo planifikuar drejtë nevojat reale për furnizime.	Kryetari duhet të sigurojë se njësitë kërkuese analizojnë dhe planifikojnë drejtë nevojat vjetore për furnizim, dhe se kontratat realizohen sipas kushteve dhe sasive të kontraktuar.	Nuk i kemi tejkalluar planifikimet.	E zbatuar	S'ka

2	Çështja B1 – Vonesa në pagesën e obligimeve financiare	LMFPP dhe Rregulla financiare Nr.01/2013/MF për shpenzimin e parave publike, përcakton se çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Në pesë pagesa për shërbime kontraktuese tjera, kompjuter më pak se 1,000 €, mirëmbajtja e veturave, mirëmbajtja e autorrugëve dhe karburant për vetura në vlerë totale 24,609 €, kemi identifikuar vonesa në ekzekutimin e faturave përtej afatit të përcaktuar. Vonesat ishin nga 11 deri 60 ditë pas afatit të përcaktuar prej 30 ditëve. Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në menaxhimin dhe procesimin e pagesave.	Kryetari duhet të sigurojë se obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturës.	Jemi munduar që vonesat të eliminohen dhe të shtohen kontrollet në menaxhimin dhe procesimin e pagesave.	Pjesërisht i zbatuar	Mungesa e mjeteve dhe njësitë përgjegjëse
3	Çështja B2 – Rritje e llogarive të arkëtueshme	Sipas nenit 26 të Ligjit nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbareuese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë eurove (10 €). Gjithashtu, neni 27 përcakton që, nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar	Kryetari duhet të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmes ndërmarrjes së veprimeve ligjore apo masave tjera informuese, me qëllim të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e të hyrave.	Kemi shtuar kontrollin në mbledhjen e të hyrave, si dhe ndërmarrjen e veprimeve ligjore ndaj debitorëve.	Pjesërisht e zbatuar	

		plotësisht tatimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Komuna ka shpalosur në pasqyrën financiare të vitit 2022 llogari të arkëtueshme në vlerë totale 716,602 €. Pjesa më e madhe e tyre i takon tatimit në pronë në vlerë 440,629 8 apo rreth 62%, taksa për ushtrimin e veprimtarisë në vlerë 266,032 € apo rreth 37%, dhe shfrytëzimi i pronës publike në vlerë 9,940 € apo rreth 1%. Llogaritë e arkëtueshme kanë tendencë rritje, dhe në krahasim me vitin paraprak rritja e tyre është 73,455 €. Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në mbledhjen e të hyrave, mos ndërmartja e veprimeve ligjore ndaj debitorëve, si dhe nga bartja e borxheve të vjetra nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike.				
4	Çështja C1 – Zotimet e mjeteve dhe urdhërblervjeve në SIMFK pas pranimit të faturave	Neni 22 i rregullës Financiare Nr.01/2013/MF – Shpenzimi i parasë publike, përcakton procedurat e përgjithshme për procedimin e pagesave. Nga kjo, kërkohet që zotimi dhe urdhërblervja t'i paraprijë pranimit të punëve, mallrave dhe	Kryetari duhet të sigurojë që procesit të blervjeve t'i paraprijë zotimi i mjeteve financiare në SIMFK, dhe të vazhdohet më tej me përgatitjen e urdhërblervjes për punët, furnizimet apo shërbimet e kontraktuara.	Është shtuar kontrolli në zotimin e mjeteve dhe është bërë përgatitja e urdhërblervjeve me kohë në SIMFK.	Pjesërisht e zbatuar	Mungesa e mjeteve sepse disa pagesa varen nga T.H.V

		shërbimeve, si dhe pranimi të faturës. Në pesë pagesa për Mallra e Shërbime, në vlerë totale 23,893 €, zotimi i mjeteve dhe përgatitja e i urdhërblerjeve në SIMFK ishte bërë me vonesë, përkatësisht pas pranimi të furnizimeve dhe faturave. Ndërsa në shtatë pagesa tjera në vlerë totale 62,269 €, tre nga to për Mallra dhe Shërbime dhe katër nga investimet kapitale, ndonëse mjetet ishin zotuar me kohë në SIMF, urdhërblerjet ishin përgatitur me vonesë apo pas pranimi të faturave. Vonesat ishin nga 1 deri 84 ditë. Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në zotimin e mjeteve dhe përgatitja e urdhërblerjeve me kohë në SIMFK.				
5	Çështja C 2 – Përbërja jo e plotë e komisionit dhe përdorimit jo standard i formularëve në procesin e mbështetjes financiare të Organizatave Jo Qeveritare (OJQ)	Me Rregulloren MF-Nr-04/2017 për procedurat e financimit publik të Organizatave Jo Qeveritare (OJQ) janë përcaktuar formularët standard që duhet të përdoren nga Organizatat Buxhetore (OB) me rastin e vlerësimit të kërkesave për mbështetje financiare. Gjithashtu, me nenin 8, kërkohet që komisioni vlerësues të përbëhet nga pesë anëtarë. Në tre procese të subvencionimit të OJQ-ve, SH.K.A	Kryetari duhet të sigurojë që komisioni vlerësues të përdorë formularët standard të vlerësimit të kërkesave për subvencionim, si dhe përbërja e komisionit vlerësues të jetë sipas kërkesave të rregullores për financimin publik të OJQ-ve.	Komisioni vlerësues ka përdorur formularët standard të vlerësimit të kërkesave për subvencionim, është bërë bëhet informimi i mjaftueshëm nga drejtoria dhe anëtarët e komisionit përkatës lidhur me kërkesat dhe procedurat e rregullores për subvencionimin e OJQ-ve. Komisioni i ndarjes së subvencioneve në fushën e Kulturës, Rinisë, Sportit dhe OJQ tjera është formuar dhe i përbërë	E zbatuar	

	“Sharri” për projektin në vlerë 3,000 €, K.F “Sharri” për projektin në vlerë 11,000€, dhe Klubi i Mundjes “Dardania” për projektin në vlerë 3,000 8, anëtarët e komisionit nuk kanë përdorur formularët standard të vlerësimit të kërkesave për financim, dhe se komisioni i vlerësimit të kërkesave ishte i përbërë me vetëm tre anëtarë. Kjo ka ndodhur për shkak të mos informimit të mjaftueshëm nga drejtoria dhe anëtarët e komisionit përkatës lidhur me kërkesat dhe procedurat e rregullores për subvencionimin e OJQ-ve.		nga 5 anëtarë sipas rekomandimit, vendimi me numër 02/3611/2023 i datës 27.04.2023.		
--	--	--	---	--	--



Republika e Kosovës - Republic of Kosova
Ndërmarrja Publike Lokale
“PASTRIMI”SH.A
Hani i Elezit



Nr.Prot.84/2023

Data:04.10.2023

Data:	04.10.2023
PËR:	KPF dhe Kuvendin e Komunës së Hanit të Elezit
PËRMES:	Kryesues i Komisionit të Aksionarëve – znj.Sevime Bajrami
NGA:	Ndërmarrja Publike Lokale e Mbeturinave - NPL“PASTRIMI” SH.A
LËNDA:	Informatë mbi raportin për periudhën Korrik – Shtator / 2023 – Npl ”Pastrimi” Sh.a

Të nderuar anëtarë të KPF-së dhe Kuvendit të Komunës

Me anë të këtij raporti, ju përcjellim informatën për periudhën Korrik - Shtator /2023 për Ndërmarrjen Publike Lokale të Mbeturinave - Npl “Pastrimi” Sh.a.

Informatë mbi raportin Korrik - Shtator / 2023 të NPL”PASTRIMI” SH.A

Me respekt.

RAPORTI PËR PERIUDHËN KORRIK – SHTATOR / 2023, I NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE TË MBETURINAVE - NPL"PASTRIMI" SH.A

Ky raport është përgatitur për periudhën Korrik – Shtator / 2023, në bazë të ligjit për Ndërmarrjet Publike - Ligjit Nr.03/L-087, të nenit 31 dhe nenit 14, paragrafit 14.2 dhe Statutit të Ndërmarrjes Publike Lokale "Pastrimi" Sh.a. Ndërmarrja Publike Lokale – NPL "PASTRIMI" SH.A, bënë menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Hanit të Elezit, ku përfshihen me shërbim të gjitha lokalitetet e komunës.

Ndërmarrja Publike Lokale – Npl "Pastrimi" Sh.a, në total ka njëzet e katër punëtor (24), ku prej tyre nëntëmbëdhjetë punëtor (19) janë të rregullt dhe pesë (5) punëtor me kontratë për "kohë të caktuar" si vijon:-

- 1 Kryeshef Ekzekutiv
- 1 Sekretar i Ndërmarrjes - Këshilltar
- 1 Zyrtar i Lartë Financiar – Thesarë
- 1 Arkëtar/e
- 1 Zyrtar i Prokurimit
- 1 Inkasant
- 1 Punëtor (asistent - mirëmbajtës i programit "Pro Data")
- 3 Shofer
- 3 Punëtor teknik
- 11 Pastrues (Grumbullues të mbeturinave)

Sa i përket periudhës së muajve Korrik – Shtator 2023 ka qenë një periudhë e angazhuar dhe me aktivitete të ndryshme nga punëtorët e ndërmarrjes publike "Pastrimi" Sh.a në pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve në qytet dhe në fshatra përreth. Gjatë kësaj periudhe janë kryer disa punë si:- pastrimi i varrezave të dëshmorëve në Pustenik, pastrimi i rrugës për Pustenik, pastrimi i përroit në Lagjen e Re, pastrimi i rrugës për në fshatin Laç, pastrimi i magjistrales "Adem Jashari" – Uji i Thartë, pastrimi i rrugës Seçishtë – Krivenik, pastrimi dhe mirëmbajtja e varrezave të qytetit në rrafsh, pastrimi dhe mirëmbajtja e parkut të qytetit "Isa Berisha", pastrimi i rrugës në fshatin Gorancë, pastrimi dhe mirëmbajtja e parkut të eksodit "Blacca 99", aktivitete të cilat i kemi publikuar në ueb faqe të ndërmarrjes publike - Pastrimi. Në muajin korrik dhe gusht ndërmarrja publike lokale "Pastrimi", dhe zyra e punësimit - dega në Hani të Elezit kanë nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi për pranimin e tre punëtorëve me kontratë pune për kohë të caktuar për gjashtë (6) muaj të cilët i paguan zyra e punësimit në lartësi prej 70% të pagës mujore, ndërsa pjesën tjetër e paguan NPL-ja, dhe një punëtor tjetër me kontratë pune për kohë të caktuar për gjashtë (6) muaj të cilin e paguan Npl "Pastrimi" Sh.a.

Në muajin gusht ndërmarrja publike lokale "Pastrimi" ka hapur një konkurs për plotësimin e vendeve të lira të punës në pozitën e punës "Grumbullues i mbeturinave", ku në këtë pozitë kanë aplikuar tre aplikant dhe pas kryerjes së procedurave të konkursit është përzgjedhur kandidati i cili ka qenë më i suksesshmi në pikët e arritura në testin me shkrim dhe gjatë intervistës.

Lista e punëtorëve të NPL-së, pozita e vendit të punës dhe paga e tyre si vijon:-

Nr.	Pozita	Nr. Punëtorëve	Paga Bruto
1	Kryeshefi Ekzekutiv	1	682.5
2	Zyrtari i Larte Financiar - Thesarë	1	423.85
3	Sekretar i Ndërmarrjes - Këshilltar	1	423.85
4	Arkëtar/e	1	423.85
5	Shofer	2	362.5
6	Shofer – mbykqyres i punëtorve në teren	1	423.85
7	Inkasant	1	362.5
8	Grumbullues i mbeturinave	11	303.01
9	Punëtor teknik	3	303.01
10	Zyrtar i prokurimit	1	120
11	Punëtor (mirëmbajtës i prog. Pro Data)	1	120
	TOTALI I STAFIT TË NPL-SË	24	

Gjatë peridhës së muajve Korrik – Shtator / 2023, janë mbajtur tre (3) mbledhje me Bordin e Drejtorëve të Npl "Pastrimi" Sh.a.

Çmimoret e kontratave janë:-

- Kontratë familjare **6.50 €**, në muaj,
- Kontratë e mesme – biznes **10.40 €**, në muaj,
- Kontratë me zbrazje – biznes **16.90 €**, për çdo zbrazje të kontenjerit **1100L**.

Gjatë periudhës së muajve Korrik – Shtator / 2023, janë nënshkruar disa kontrata me klient të rinjë të Npl"Pastrimi" Sh.a, ato janë:-

- Kontratë familjare **11** ,
- Kontratë biznesore **4** ,
- Institucionale **0**.

Totali i kontratave të nënshkruara nga viti 2017 – Shtator / 2023 janë si vijon:-

- Ekonomitë familjare ----- **1487**
- Kontratë biznesore ----- **102**
- Kontratë institucionale ----- **10**
- Totali i kontratave ----- **1599**

Hani i Elezit
04.10.2023

Zyra e Npl "Pastrimi" Sh.a
Hani i Elezit

1. Hyrje

Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2023, është përgatitur në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, të nenit 14, paragrafët 14.2 si dhe statutit të Ndërmarrjes Publike Lokale.

Ky raport përmban një përmbledhje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore të kompanisë së mbeturinave përgjatë periudhës Janar – Shtator 2023. Raporti pasqyron të hyrat e kompanisë, si dhe krahasimet me periudhë paraprake.

1.1. Performanca e të hyrave nga shërbimet

Të hyrat nga shërbimet kanë arritur vlerën 145.448,51 euro duke shënuar trende rritëse me 9.7 % që korrespondon me 12.888,97 euro më shumë krahasuar me të hyrat e vitit 2022.

Performanca e shpenzimeve të kompanisë

Shpenzimet e kompanisë kanë arritur vlerën prej 147.637,45 euro duke shënuar një rritje prej 13 % që korrespondon me 11.071,45 euro më shumë krahasuar me vitin paraprak.

- **Shpenzimet për paga dhe mëditje** shënuan vlerën e 85.635,94 € duke shënuar një rritje prej 2,785.33 € apo 3.3% krahasuar me vitin 2022.
- **Shpenzimet në tatime** shënuan vlerën e 5.385,22 euro duke shënuar një rritje prej 4.785.22 euro më shumë krahasuar me vitin 2022.
- **Shpenzimet për mallra dhe shërbime** shënuan vlerën prej 56.616.29 € duke shënuar një rritje prej 9.501,22 € apo 20 % krahasuar me vitin 2022.

2. TË HYRAT E KOMPANISË

	TE HYRAT	2022	2023	Krahasimi
1	Të hyrat nga Shërbimet	132,559.54	145,448.51	12,888.97
2	Te hyra tjera	-	2,772.00	2,772.00
3	Paraja në bankë	1,127.60	2,046.46	918.86
	TOTALI	133,687.14	150,266.97	16,579.83

3. SHPENZIMET E KOMPANIS

3.1 PAGA DHE MEDITJE

A	PAGAT DHE MEDITJET	2022	2023	Krahasimi
1	PAGAT NETO + SHUJTA	73,088.21	74,536.22	1,448.01
2	KONTRIBUTI I PUNEMARRSIT	3,537.05	3,990.14	453.09
3	KONTRIBUTI I PUNEDHENESIT	3,537.05	3,990.14	453.09
4	TATIMI NE BURIM	2,688.61	3,119.44	430.83
	TOTALI	82,850.92	85,635.94	2,785.02

3.2 TATIMET

B	TATIMET	2022	2023	Krahasimi
1	TVSH-ja 8%	-	4,685.22	4,685.22
2	KESTET TREMUJORE (ATK)	600.00	700.00	100.00
3	TATIMI VJETOR MBI KORPORATA	-	-	-
	TOTALI	600.00	5,385.22	4,785.22

3.3 MALLRA DHE SHERBIME

C	MALLRA DHE SHËRBIME	2022	2023	Krahasimi
1	Shpenzime për karburant	20,644.47	19,924.59	-719.88
2	Shpenzimet e deponisë (KMDK)	7,083.22	11,093.98	4,010.76
3	Shpenzimet për internet	99.9	150	50.10
4	Shpenzimet e Mirëmbajtjes së Mjeteve	8,535.66	10,909.00	2,373.34
5	Furnizim me Rrë I II III	180		-180.00
6	Shpenzime për Softuer Kompjuterik	400	590	190.00
7	Shpenzime për zyre dhe administrative	198	1,771.30	1,573.30
8	Shpenzime për zyre pajisje dhëmjete pune	5,078.86	6,690.09	-1,1611.23
9	Shpenzime për trajnime	794	790	-4.00
10	Shpenzimet e Reprezentacionit	2,146.80	576.10	-1,570.70
11	Shpenzimet e Sigurimit	1,361.86	1,343.48	-18.38
12	Shpenzime Telefoni - (Mbushje)	280	756.95	476.95
13	Provizione Bankare NLB BANK	110.5	120.8	10.30
14	Çertifikata për shofer kamioni	120		-120.00
15	Çertifikata shëndetsore	64		-64.00
16	Licence	17.8	500	482.20
17	Uniforma Pune	-	1,400.00	-
17	Shpenzimet e rrym	-		-
	TOTALI	47,115.07	56,616.29	9,501.22

3.4 TOTALI I TE HYRAVE DHE SHPENZIMEVE

	TE HYRAT	2022	2023	Krahasimi
1	Të hyrat nga Shërbimet	132,559.54	145,448.51	12,888.97
2	Te hyra tjera (Ministria e Punes)	-	2,772.00	2,772.00
3	Paraja në bankë	1,127.60	2,046.46	918.86
	TOTALI	133,687.14	150,266.97	16,579.83
	SHPENZIMET			
	Shpenzime Tjera A+B+C+D+E	130,565.99	147,637.45	17,071.46
	Fitimi/Humbja	3,121.15	2,629.52	(491.63)



STRATEGJIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK
2023-2027
HANI I ELEZIT



STRATEGJIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK HANI I ELEZIT 2023 - 2027

Ky dokument është përgatitur nga Komuna e Hanit të Elezit, respektivisht nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Komunës së Hanit të Elezit.

Hani i Elezit, 2023

Fjala e Kryetarit të Komunës

Të nderuar bashkëvendas,

Strategjia për Zhvillim Ekonomik 2023-2027 është një nga dokumentet kyçe që posedon institucioni komunal, përmes së cilit identifikohet potenciali zhvillimor ekonomik që posedon Komuna e Hanit të Elezit.

Në kohët e tashme, është e rëndësishme të kemi një vizion të qartë për të ardhmen ekonomike të komunës sonë. Një strategji e mirëplanifikuar dhe e mirëhartuar do të na ndihmojë të identifikojmë sfidat, të përcaktojmë objektivat dhe të zhvillojmë veprime të qëndrueshme për të forcuar zhvillimin ekonomik.

Qëllimi i kësaj strategjie është të krijojmë një mjedis të favorshëm për investime, inovacion dhe rritje të qëndrueshme. Nëpërmjet studimeve të hollësishme dhe konsultimeve të përgjegjshme me përfaqësuesit e drejtorive komunale, zyreve dhe njësisë komunale, shoqërisë civile, komiteteve konsultative komunale dhe bashkëpunëtorët nga agjencionet zhvillimore, kemi identifikuar disa sektorë kyç për ta fokusuar përkushtimin tonë.

Në këtë strategji, fokusohemi në përmirësimin e infrastrukturës së transportit, krijimin e një ambienti të favorshëm biznesor, mbështetjen e sektorit të turizmit dhe ndërtimit të kapaciteteve të komunitetit lokal. Ne i shikojmë këta sektorë si motorë të zhvillimit ekonomik të komunës sonë dhe do të ndërmarrim hapa konkretë për të stimuluar rritjen dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Kam besim të plotë në potencialin e Komunës së Hani i Elezit dhe në aftësitë e banorëve tanë për të krijuar një të ardhme të ndritur. Së bashku, do të ndërtojmë bazën e një ekonomie të qëndrueshme dhe të forcojmë pozicionin tonë në nivel vendi dhe rajoni.

Ju faleminderit për vëmendjen dhe mbështetjen tuaj në këtë dokument. Së bashku, mund të bëjmë ndryshime reale dhe të krijojmë një qytet vendqëndrues dhe jo vetëm si vendkalues.

Ju faleminderit!"

Përmbajtja

Grupi Punues	5
Indeksi i shkurtesave	6
Indeksi i tabelave	7
Indeksi i figurave	8
Grafiku	8
Hyrja	9
1. Metodologjia	10
2. Historiku	13
2.1. Pozita gjeografike	14
2.2. Kushtet klimatike dhe relievi	15
2.3. Popullsia dhe vendbanimet	16
3. Zhvillimi ekonomik	21
3. Zhvillimi ekonomik	21
3.1. Sektori privat	21
3.2. Regjistrimi bizneseve sipas llojit të biznesit	22
3.3. Regjistrimi i pronarëve të bizneseve sipas gjinisë	22
3.4. Regjistrimi bizneseve 2019-2022	23
3.5. Industria	24
3.6. Fuqia punëtore, punësimi dhe papunësia	25
3.7. Burimet kryesore të jetesës	26
4. Bujqësia	28
4.1. Toka bujqësore	28
4.2. Prodhimet bujqësore	29
4.3. Blegtoria	30
4.4. Pyjet	30
5. Arsimi	32
6. Shëndetësia dhe mirëqenia sociale	36
6.1. Sektori privat	Error! Bookmark not defined.
7. Hapësirat Publike	38
7.1. Parku i Qytezës	38
7.2. Koridoret e gjelbëra	38
7.3. Menaxhimi i mbeturinave	38
7.4. Hapësirat e gjelbërta	39

7.5.	Degradimi i mjedisit	40
7.6.	Ndotja e ujit	40
7.7.	Ndotja e tokës	41
7.8.	Ndotja akustike	41
8.	Infrastruktura	43
8.1.	Transporti	44
8.2.	Resurset ujore dhe menaxhimi i tyre	45
8.3.	Mbulimi me shërbimin e kanalizimit	48
9.1.	Kultura	51
9.	Kultura dhe Sporti	51
9.2.	Sporti	51
9.3.	Turizmi	51
10.	Buxhet	53
10.1.	Të hyrat komunale	54
10.2.	Shpenzimet Buxhetore	54
	Analiza SWOT	56
	Vizioni dhe Misioni	57
	Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2027	57
	Objektivat e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik	58

Grupi Punues

Majlinda Kaloshi - Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik, Udhëheqëse e grupit
 Sevdî Dernjani - Nënkyetar i komunës
 Kimete Kuka - Drejtoreshë për Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale
 Hisni Luri - Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
 Nexhmedin Daci - Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit
 Lindita Ballazhi - Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
 Natyra Kalisi - Drejtoreshë për Administratë
 Arsim Dernjani - Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencë
 Abduraman Bushi - Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
 Durim Dernjani - Menaxher i Projekteve
 Bajrush Laçi - Shef i zyrës ligjore dhe përfaqësues juridik
 AZHR Lindje - Agjencion Rajonal për Zhvillim

Teuta Hasallari - Përfaqësuese e KVRL-së
 Amir Qajani - Konsulent i jashtëm
 Florim Shkreta – Anëtar i Asamblesë Komunale
 Resul Suma - Anëtar i Asamblesë Komunale
 Sherif Berisha - Anëtar i Asamblesë Komunale
 Hyrijete Isufi - Anëtare e Asamblesë Komunale
 Ibadete Kuka – Anëtare e Asamblesë Komunale
 Zaim Bela - Anëtar i Asamblesë Komunale
 Nora Xhoni – Anëtare e Asamblesë Komunale
 Refet Kalisi - Anëtar i Asamblesë Komunale

Kontribues të tjerë:

Fatbardha Bushi – Inspektore për Mjedis
 Bujar Bushi – Zyrtar për Regjistrim të Bizneseve
 Amir Berisha – Inspektor i Komunikacionit
 Rezart Memedi – OSCE

Indeksi i shkurtesave

AMF	Ambulancës së Mjekësisë Familjare
APK	Agjencia e Pyjeve të Kosovës
ARRU	Autoriteti Rregullativ për Ujësjetllës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
EAMS	Sistemin e Menaxhimit të Aseteve të Ndërmarrjes
DAKRS	Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
DZHE	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
DSHMS	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
DSHPE	Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë
DUKMM	Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit
FAO	Organizata Botërore e Ushqimit
KKEE	Fondi Kosovar për Eficiencë të Energjisë
GIZ	Organizata Gjermane për Shoqëri të Hapur
GZK	Gazeta Zyrtare e Kosovës
IHMK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
IKMN	Instituti Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës
IMMK	Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës
IPA	Instrumenti i Para Anëtarësimit
JICA	Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtarë
KINP	Kontrolli i Integruar për Parandalimin e Ndotjes
KVRL	Këshilli Rinor për Veprim Lokal

KINP	Kontrolli i Integruar për Parandalimin e Ndotjes
KVRL	Këshilli Rinor për Veprim Lokal
KRU	Kompania Regjionale e Ujësjellësit
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MFK	Fondacioni Kosovar i Mileniumit
NPL	Ndërmarrja Publike Lokale
KIPM	Kontrollin e Integruar për Parandalimin e Ndotjes
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	Organizata Joqeveritare
PKVEE	Plani Komunal i Veprimit për Eficencë të Energjisë për Komunën e Hanit të Elezit 2019-2021
PLVM	Plani Lokal i Veprimit në Mjedis
PNJK	Pilot Njësi Komunale
PRU	Plani Rregullues Urban i Komunës së Hanit të Elezit
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Hanit të Elezit 2010-2025+
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
SHFMU	Shkolla fillore e mesme e ulët
SHML	Shkolla e mesme e lart

Indeksi i tabelave

Tabela 1: Dokumentet strategjike dhe planifikuese të Komunës së Hanit të Elezit

Tabela 2: Popullsia dhe, ekonomitë familjare sipas lokaliteve të Hanit të Elezit

Tabela 3: Regjistrimi bizneseve sipas llojit të biznesit.

Tabela 4: Regjistrimi i pronarve të bizneseve sipas gjinisë

Tabela 5: Regjistrimi bizneseve 2019-2022

Tabela 6: Punësimi

Tabela 7: Numri i të punësuarve dhe të papunëve nga popullsia e aftë për punë

Tabela 8: Burimet kryesore të jetesës

Tabela 9: Sipërfaqja e tokës bujqësore

Tabela 10: Sipërfaqja e kultivuar bujqësore

Tabela 11: Numri i krerëve të kafshëve blegtorale

Tabela 12: Niveli i arsimimit në Han të Elezit dhe Kosovë

Tabela 13: Stafi shëndetësor në Han të Elezit i ndarë sipas shërbimeve të ofruara

Tabela 14: Infrastruktura në komunën e Hanit të Elezit

Tabela 15: Infrastruktura transportuese rrugore dhe hekurudhore në territorin e komunës së Hanit të Elezit

Tabela 16: Shërbimi i ujësjellësit sipas vendbanimeve

Tabela 17: Mbulushmëria me shërbimin e ujësjellësit

Tabela 18: Shërbimi i kanalizimit sipas vendbanimeve

Tabela 19: Mbulushmëria me shërbimin e kanalizimit

Tabela 20: Numri i klientëve të shërbyer dhe gjatësia e rutës së shërbimit për vendbanime
Tabela 21: Emetimet në ajër nga Sharrcem (2018-2020)
Tabela 22: Përqendrimet vjetore dhe tejkallimet e standardeve kosovare për ndotës të caktuar (2018-2022)
Tabela 23: Të hyrat vetanake
Tabela 24: Transferat qeveritare
Tabela 25: Shpenzimet komunale

Indeksi i figurave

Figura 1: Metodologjia e hartimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomike
Figura 2: Pozita gjeografike e komunës së Hani të Elezit
Figura 3: Harta relievore e Komunës së Hanit të Elezit
Figura 4: Harta e qyteti dhe fshatrave të Komunës së Hanit të Elezit
Figura 5 : Harta e objekteve shkollore dhe shëndetësore të Komunës së Hanit të Elezit
Figura 6: Harta infraskturore urbane e territorit të komunës së Hanit të Elezit
Figura 7: Harta e rrugëve dhe transportit publik
Figura 8: Skema e Procesit të prodhimit dhe ndikimit në mjedis të Sharrcemit

Grafiku

Grafiku 1: Struktura etnike në Komunën e Hani të Elezit
Grafiku 2: Popullsia në komunën e Hanit të Elezit, 1948-2011
Grafiku 3: Struktura gjinore në komunën e Hani të Elezit
Grafiku 4: Shpërndarja e moshave në komunën e Hani të Elezit
Grafiku 5: Regjistrimi bizneseve sipas llojit të biznesit
Grafiku 6: Regjistrimi i pronarëve të bizneseve sipas gjinisë
Grafiku 7: Regjistrimi bizneseve 2019-2022
Grafiku 8: Numri i stafit në institucionet publike parauniversitare, 2018-2022
Grafiku 9: Numri i nxënësve në institucionet publike parauniversitare, 2018-2022
Grafiku 10: Buxheti i komunës së Hanit të Elezit për vitet 2021-2025

Zhvillimi i qëndrueshëm urban i një vendi, me rini që janë të orientuar nga inovacioni dhe teknologjia, promovimi i potencialeve dhe resurseve natyrore pa ndikuar negativisht në ambient, përkrahje të bizneseve dhe industrisë në tërësi e përbëjnë procesin zhvillim ekonomik të një vendi, me qëllim të gjenerimit të vendeve të reja të punës.

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal është një dokument që prezanton përcaktimin e synimeve, qëllimet strategjike, sfidave që përballen vendi, objektivat e së ardhmes, buxhetin dhe proceset e vlerësimit të projekteve, duke zhvilluar një vizion afatgjatë të Komunes së Hanit të Elezit. Ajo ka rëndësinë e një materiali largpamës dhe vizionar duke tentuar drejtë një zhvillimi të qëndrueshëm ndërmjet shfrytëzimit të potencialeve poseduese.

Përmes këtij dokumenti strategjik Komuna e Hanit të Elezit paraqet një planifikim gjithëpërfshirës për një orientim drejtë një zhvillimi të qëndrueshëm duke prekur të gjithë sektorët që do të ndikojnë për një periudhë kohore, 2023-2027. Vizioni për pesë vitet e ardhshme e projekton Hanin e Elezit si një qytet relativisht të ri por njëkohësisht mjaftë të zhvilluar duke rigjeneruar zonat urbane, zhvillim të balancuar, arsim cilësor, kushte shumë të mira shëndetësore, infrastrukturë të përmirësuar teknike duke siguruar një mirëqenie për të gjithë.

Institucioni duhet të strukturojë dhe menaxhojë administratën e saj, buxhetin dhe proceset e planifikimit për t'i dhënë përparësi nevojave themelore të komunitetit dhe të promovojnë zhvillimin social dhe ekonomik të saj.

1. Metodologjia

Me rekomandim të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik pranë Komunës së Hanit të Elezit, Kryetari i Komunës ka themeluar grupin punues për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik në të cilin janë përfshirë të gjitha grupet e interesit. Në këtë strukturë kanë qenë pjesëmarrës drejtoritë komunale, zyrtar komunal, organizata joqeveritare, agjenci zhvillimore, përfaqësues të bizneseve, konsulentë të jashtëm dhe pjesë të shoqërisë civile.

Për hartimin e këtij dokumenti, udhëheqësi i grupit, ka përgatitur planin e hartimit të tij e që ka përfshirë këto faza:




Figura. 2 Metodologjia e hartimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomike

Gjatë hartimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomike të komunës së Hanit të Elezit janë mbajtur takime të rregullta pune me përfaqësuesit e komunës së Hanit të Elezit, përfaqësues të shoqërisë civile, bizneset lokale etj.. Si rrjedhojë janë identifikuar aktet kryesorë dhe përfaqësuesit e tyre janë përfshirë në ekipin e punës. Tutje është bërë planifikimi i procesit të hartimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomike. Pastaj janë mbledhur të dhënat nga mbi veçoritë gjeografike dhe demografike, arsimin, shëndetësinë, mirëqenien sociale, tregun e punës, industrinë, shërbimet administrative të komunës, infrastrukturën, furnizimin me ujë të pijshëm, mbeturinat, ndotjen, kulturën, sportin dhe ekonomin lokal të komunës së Hanit të Elezit

Strategjia për Zhvillim Ekonomik mbështetet me projekte për arritjen e objektivave zhvillimore të cilat reflektojnë interesat e qytetarëve, komunitetit të biznesit dhe aktet tjerë në komunën e Hani të Elezit, për të krijuar dhe ofruar kushte cilësore të jetesës për qytetarët e kësaj komune. Ky dokument strategjik bazohet në politikat strategjike për zhvillim ekonomik lokal si:

Dokumenti	Qëllimi dhe fushëveprimi
Statuti i Komunës së Hanit të Elezit	Rregullon organizimin e brendshëm të komunës dhe përcakton përgjegjësitë vetanake të organeve komunale.
Profili Ekonomik i Komunës 2022/2023	Pasqyron Profili Ekonomik i Komunës
Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Hanit të Elezit 2010-2025+	Është bazë për zhvillim të qëndrueshëm në komunën e Hanit të Elezit, dhe synon ruajtjen e mjedisit, shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve për zhvillim ekonomik, për gjeneratat e ardhshme dhe balancimin e zhvillimeve hapësinore. Përmes këtij plani koordinohen kërkesat sociale dhe ekonomike për hapësirën me funksionet e saj kulturore dhe ekologjike.
Plani Rregullues Urban i Komunës së Hanit të Elezit	Qëllimi i këtij plani është që të organizojë ndërtimet në pjesën urbane të qytetit që është edhe pjesa identifikuese e komunës së Hanit të Elezit.
Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2012-2017	Dokument lokal që është zbatuar gjatë periudhës 2012-2017 me synim që të zgjidh problemet mjedisore nëpërmjet identifikimit të prioriteteve dhe përcaktimit të veprimeve për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë të gjithë aktorët e mundshëm për përcaktimin e këtyre veprimeve dhe krijimin e strategjive për zbatimin e tyre në mënyrë efektive, të ndërthurura.
Plani për Menaxhimin e Mbeturinave, Komuna e Hanit të Elezit 2016-2021	Plani Komunal i Menaxhimit të Mbeturinave të Hanit të Elezit është dokument planifikimi që rregullon Menaxhimin e Mbeturinave në nivel lokal. Plani synon shtrirjen e shërbimit për menaxhimin e mbeturinave komunale në të gjithë territorin e komunës.
Plani Komunal i Veprimit për Eficencë të Energjisë për Komunën e Hanit të Elezit (PKVEE) 2019-2021	Objektivi i PKVEE është zvogëlimi i konsumit të energjisë në objektet publike, transport dhe ndriçim publik, rritja e nivelit të komoditetit, zvogëlimi i kostos së shpenzimeve të energjisë si dhe krijimi i sistemit për menaxhimin e energjisë në komunën e Hanit të Elezit.
Strategjia e zhvillimit rajonal për rajonin ekonomik lindje	Ky dokument ka paraqitur zhvillimin rajonal lindje të Kosovës, objektivat në zhvillim socio-ekonomik të komunave në lindje të Kosovës

Tabela 1 : Dokumentet strategjike dhe planifikuese të Komunës së Hanit të Elezit

A stylized, monochromatic map in shades of beige and brown. It features a network of lines representing rivers, roads, and administrative boundaries. A prominent river flows from the top left towards the bottom right. Several smaller, irregular shapes represent land parcels or fields, some with internal hatching. The overall style is minimalist and graphic.

Të dhënat Gjeografike dhe Demografike

Komuna ka gjithsej 11 zona kadastrale, dy prej të cilave kanë qenë të shpopulluara që nga viti 1999. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës nga regjistrimi i popullsisë së vitit 2011, Komuna e Hanit të Elezit ka 9.403 banorë. Që nga themelimi i fabrikës së çimentos në vitin 1936, numri i popullsisë në Hanin e Elezit është rritur vazhdimisht.

Territori i sotëm i komunës, dikur ishte i njohur me emrin Sar, dhe ka qenë i banuar që prej kohës së Romakeve. Këtë e vërtetojnë zbulimet e materialeve të ndryshme arkeologjike, siç është mbishkrimi në gjuhë latine i një perandori romak. Zbulimet e materialeve të vjetra në afërsi të rrugëve që e lidhnin dikur rajonin me Scupi-n (Shkupin e sotëm), mbështesin idenë se në këtë rajon ka ekzistuar një vendbanimi Ilir. Kjo argumentohet me gjetjen e materialeve arkeologjike të kalasë (castela). Gjetje janë bërë edhe në shumë fshatra të kësaj komune siç janë rrënojat e kishës dhe manastirit të gjetura në Gorancë pastaj, në Paldenicë janë gjetur mbeturinat e një nekropoli, qeramika të vjetra, materiale bronz, një stelë nga një varrezë e shekullit të tretë pas Krishtit dhe dy monedha. Në fshatin Dërmjak është gjetur një statujë romake dhe ekzistojnë edhe shumë materiale të tjerat të lashta, të cilat janë gjetur në fshatrat tjera.

Edhe pse Hani i Elezit dhe rrethinat e saj kanë pasur statusin e një komune që nga viti 1913, një ndarje e re administrative e miratuar në vitin 1961, ka themeluar komuna më të mëdha dhe ka shkrirë territorin e Hanit të Elezit në komunën e Kaçanikut. Hani i Elezit është themeluar si Pilot Njësi Komunale (PNJK) si rezultat i procesit të decentralizimit në shtator të vitit 2005, në bazë të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut nr. 2005/11 për krijimin e Pilot Njësi Komunal. Më 13 gusht të vitit 2008 ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), me shkresë njoftuese nr. 02-527 njoftoi se, komuna e Hanit të Elezit është certifikuar në të njëjtin nivel të kompetencave dhe përgjegjësi me komunat tjera në Republikën e Kosovës.

